



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-197**

**PËR KIMIKATE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR KIMIKATE**

**KREU I**  
**DISPOZITAT E PERGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është menaxhimi i drejtë i kimikateve të rrezikshme, mbrojtja dhe zvogëlimi i rrezikut të mundshëm nga kimikatet, të cilat mund të ndikojnë dhe shkaktojnë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Ky ligj përcakton kushtet për vendosjen në treg të substancave dhe pëzierjeve të rrezikshme si dhe pëcaktimin e mënyrës së kontrollimit të tyre; pëcaktimin dhe vlerësimin e rreziqeve që mund të ndikojnë dëmshëm në shëndetin e njeriut dhe mjedisin; shqyrtimin dhe lëshimin e

lejeve për qarkullimin, trajtimin dhe përdorimin e kimikateve dhe; mbajtjen e regjistrit të kimikateve; regjistrin e personave fizik dhe juridik që tregtojnë dhe përdorin kimikatet; kushtet për klasifikimin, etiketimin, paketimin, importin, eksportin dhe tranzitin e kimikateve të rrezikshme si dhe përgjegjësitë e autoritetit kompetent për zbatimin dhe monitorimin e këtij ligji.

2. Ky ligj gjithashtu përcakton kushtet për vendosjen në treg të detergjenteve, lëshimin e Lejeve dhe mbajtjen e regjistrit të detergjenteve.

3. Dispozitat e këtij ligji mbështeten në parimin parandalues të rreziqeve nga kimikatet.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Kimikate** - substancat dhe përzierjet /preparatet kimike;

1.2. **Substancat** - elementet kimike ose bashkëdyzimet e tyre në gjendje natyrore, ose të përfituara nga ndonjë proces prodhimi, duke përfshirë çdo lëndë shtesë të nevojshme që shërben për ruajtjen e qëndrueshmërisë së tyre, përkatësisht papastërtitë që rrjedhin nga procesi i prodhimit, duke përjashtuar çdo tretës që mund të ndahet pa ndryshuar qëndrueshmërinë e substancës apo përbërjen e saj;

1.3. **Përzierje** - përzierje ose tretësirë e përbërë nga dy ose më shumë substanca kimike. Fjala “Preparat” e përdorur deri me tani ka kuptimin e njejtë dhe duhet të zavendësohet me fjalen “përzierje” sipas Rregullores EC 1272/2008;

1.4. **Monomer** - molekulë që është e aftë të lidhet zinxhir me molekula të tjera duke formuar polimerë;

1.5. **Polimer** - substancë e përbërë nga dy apo më shumë monomerë të lidhur zinxhir me njëri tjetrin;

1.6. **Prodhues** - personi fizik ose juridik që prodhon kimikate;

1.7. **Prodhim** – prodhimi ose nxjerrja e substancave kimike në gjendje natyrore;

1.8. **Eksportues** - çdo person fizik ose juridik që bën eksportin e kimikateve dhe është përgjegjës për eksportimin e tyre nga territori i Republikës së Kosovës;

1.9. **Importues** - çdo person fizik ose juridik që importon kimikatet brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe që është përgjegjës për importin e tyre;

1.10. **Shpërndarës apo distributor** - çdo person fizik ose juridik, përfshirë shitësit me shumicë dhe pakicë, që merren me magazinimin dhe vendosjen në qarkullim të substancave ose përzierjeve, për palë të treta;

1.11. **Furnizues** - çdo prodhues, importues, përdorues tjetër apo shpërndarës që i vendosë në treg substancat apo përzierjet;

1.12. **Përdorues tjetër** - çdo person fizik ose juridik që ndryshe nga prodhuesi apo importuesi, i shfrytëzon substancat apo përzierjet, qoftë për nevojat e tij apo për pregaditjet në kuadër të fushëveprimtarisë së tij industriale ose profesionale. Shpërndarësi apo konsumuesi nuk është përdorues tjetër;

1.13. **Regjistrues** – prodhuesi ose importuesi i substancës apo prodhuesi ose importuesi i produktit që produktin e paraqet për regjistrim si substancë;

1.14. **Paketim** - një ose më shumë kuti dhe çdo përbërës tjetër apo material të nevojshëm për kutitë që kryejnë funksionin e mbajtjes, ruajtjes së bashku me funksione të tjera të nevojshme që kanë si qëllim sigurinë e mallit;

1.15. **Etiketim/etiketë** - vendosja e një letre, metali, plastike, lëkure ose materiali tjetër në paketim ose e një shtypje/gravimi drejtpërdrejtë në produkt, në të cilën shpjegohen të dhënat për identifikimin e produktit;

1.16. **Piktogram** – një kompozicion grafik për rrezikun i cili është i përbërë nga figura, simbole dhe elemente të tjera grafike të tilla si korniza dhe ngjyra e sfondit që ka për qëllim të paraqesë informata specifike për rrezikshmërinë në fjalë;

1.17. **Toksike** - një substancë apo përzierje kimike që është helmuese për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

1.18. **Substancë në fazën e ndërmjetme** - substanca në proces ndryshimi, përpara se të shëndrrohet në produkt final;

1.19. **Kimikatet e rrezikshme** - substancat ose përzierjet, që kanë një ose më shumë veti të rrezikshme të klasifikuara sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

1.20. **Praktikat e Mira Laboratorike (GLP- Good Laboratory Practices)** - një sistem cilësie i ndërtuar me proces organizativ dhe nën kushtet ku studimet joklinike për sigurinë e shëndetit dhe mjedisit janë të planifikuara, monitoruara, inçizuar, arkivuar dhe raportuara;

1.21. **Qarkullimi i kimikateve** - çdo aktivitet që lidhet me substancat apo përzierjet, në veçanti, me prodhimin, importin apo eksportin, vendosjen në treg, ruajtjen, mbajtjen, transportin, përdorimin ose zhvendosjen e kimikateve;

1.22. **Hulumtime dhe zhvillime shkencore** - hulumtime shkencore, analiza të substancave kimike me qëllim mbikëqyrjen dhe përcaktimin e vetive kryesore, efekteve dhe ndikimeve të substancave, si dhe hulumtimet shkencore lidhur me procesin e prodhimit;

1.23. **Emri kimik sipas emërimit të IUPAC-ut** - emri kimik i përcaktuar nga Bashkimi Ndërkombëtarë i Kimisë së Pastër e të Zbatuar (International Union of Pure and Applied Chemistry - IUPAC);

1.24. **Numri-CAS** - numri me të cilin kimikatet janë regjistruara në Regjistrin Ndërkombëtarë të Shërbimit Abstrakt për Kimikate (Chemical Abstract Service);

1.25. **Detergjentet për përdorim në industri ose për përdorim profesional** - detergjentet që përdoren për larje dhe pastrime jashtë amvisrisë, që shfrytëzohen nga persona profesional;

1.26. **Detergjentet** - substanca ose përzierje që përmbajnë sapun, substanca tension-aktive dhe përbërës të tjerë që përdoren për pastrim dhe larje;

1.27. **Substancat tension-aktive** – substancat organike ose përzierjet që janë lëndë përbërëse të detergjenteve, që veprojnë në sipërfaqe dhe përbëhen nga një ose më shumë grupe hidrophile dhe hidrofobe, dhe që kanë aftësinë të zvogëlojnë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojnë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër, duke formuar emulsione ose mikroemulsione ose micela që thithen në kontakt me ujin dhe sipërfaqet e ngurta;

1.28. **Zbërthimi primar biologjik** - ndryshimi struktural i substancave tension-aktive nën veprimin e mikro-organizmave, gjatë të cilit humbet aftësia e tyre të veprojnë në nivel sipërfaqësor për shkak të zbërthimit të strukturës së tyre;

1.29. **Zbërthim biologjik i plotë në prani të oksigjenit (aerobik)** - shkalla e zbërthimit biologjik në të cilën substancat tension-aktive, nën ndikimin e mikroorganizmave, nën prani të oksigjenit, bëjnë zbërthimin e plotë të tyre në dioksid karboni, ujë dhe kripëra minerale;

1.30. **Informimi për Pëlqim Paraprak (PIC - Prior Informed Consent)** - procedura me të cilën kimikatet që janë të ndaluara ose kufizuara në shtetin eksportues, mund të eksportohen, vetëm nëse paraprakisht njoftohet dhe merret pëlqimi nga shteti importues;

1.31. **Vendosja në treg** - importimi, porositja apo dhënia në shfrytëzim e kimikateve një personi të tretë, me ose pa pagesë;

1.32. **Tërheqja nga tregu** – është çdo aktivitet ose mase me të cilën pengohet furnizimi i mëtejshëm ose ndërprerjen e qasjes ose posedimit të kimikateve që më parë janë vendosur në treg;

1.33. **Skenari i ekspozimit** - nje mori masash dhe kushtesh, përfshi edhe kushtet e punës, masat për të menaxhuar rrezikun gjatë prodhimit të kimikateve dhe përdorimin e tyre gjatë ciklit të tyre jetësorë, si dhe mënyrën e kontrollit të kimikateve nëse ndikojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisit;

1.34. **Përdorimi** - përpunimi, shpenzimi, magazinimi, mbushja dhe zbrazja e rezervuarve, përzierjeve, prodhimi i produkteve, paketimi dhe mënyra të tjera shfrytëzimi të kimikateve;

1.35. **Pastrim** - është definicioni sipas standardit ISO 862 - Fjalor i termave për substancave tension-aktive;

1.36. **Ministria** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

1.37. **Ministri** – Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

1.38. **REACH ( Registration, Evaluation, Authorisation and Restriction of Chemicals)** – Regjistrimi, Vleresimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve sipas Regulation (EC) No 1907/2006;

1.39. **Zyrë informative / “help desk”** – zyre informative për ndihmë dhe këshilla mbi dispozitat e këtij ligji;

1.40. **Person** - çdo person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e kimikateve.

#### **Neni 4 Menaxhimi i sigurt i kimikateve**

1. Personat fizikë dhe juridik që importojnë, prodhojnë, tregtojnë dhe përdorin kimikate të rrezikshme duhet t'i menaxhojnë ato në mënyrë të sigurt, në përputhje me dispozitat ligjore, udhëzimet për përdorimin e tyre të drejtë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe në pajtim me masat që duhet të ndërmerren për dhënien e ndihmës së parë dhe në përputhje me udhëzimet për menaxhimin e mbeturinave nga kimikatet e përdorura, paketimeve dhe ambalazheve të zbrazura.

2. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të menaxhojnë dhe ndërmarrin masat për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen nga zjarri sipas përshkrimit në Listën Teknike të Sigurisë për Kimikatet dhe në përputhje me të dhëna të tjera në dispozicion.

3. Personat që përdorin kimikate të rrezikshme duhet të sigurojnë dhe përdorin udhëzimet për përdorim të drejtë të kimikateve të rrezikshme pa e rrezikuar jeten personale ose jeten e personave të tjerë.

## **Neni 5** **Përjashtimet**

1. Dispozitat e këtij ligji nuk vlejnë për:

1.1. substancat që ndodhen në magazinat doganore dhe nën mbikëqyrjen e doganës ose në zonat e lira doganore me qëllim eksportimin apo tranzitimin e tyre dhe jo përpunimin ose trajtimin;

1.2. substancat radioaktive;

1.3. produktet e ndëmjetme të paizoluara;

1.4. kimikatet që mund të përdoren për prodhimin e substancave narkotike dhe substancave psihotrope (perkursorët);

1.5. ushqimet dhe lëndët shtesë/aditivët në ushqime;

1.6. ushqimet për kafshë dhe lëndët shtesë për këto ushqime;

1.7. barnat për përdorim nga njerëzit dhe veterinaria;

1.8. mjetet mjekësore/medicionale;

1.9. substancat narkotike/drogat;

1.10. kimikatet që konsiderohen mbeturina;

1.11. municionet dhe lëndët shpërthyes/eksplozivët;

1.12. armët kimike dhe lëndët paraprirëse/perkursorët e armëve kimike;

2. Dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për kimikatet që hidhen në treg si produkte të gatshme, si:

2.1. produktet për mbrojtjen e bimëve;

2.2. produktet biocide;

2.3. produktet kozmetike.

3. Dispozitat e këtij ligji që rregullojnë klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e kimikateve nuk zbatohen për kimikatet që përdoren për studime dhe hulumtime shkencore të cilat nuk vihen në shitje dhe përdoren në mënyrë të kontrolluar.

4. Ky Ligj nuk rregullon transportimin e kimikateve të rrezikshme me transport ajror, tokësor, hekurudhor dhe me postë.

## **KREU II KIMIKATET E RREZIKSHME**

### **Neni 6 Kimikatet e rrezikshme dhe vetitë e tyre**

1. Kimikate të rrezikshme konsiderohen kimikatet që klasifikohen sipas Rregullores (EC) 1272/2008.

2. Klasifikimi i kimikateve bazohet në të dhënat për:

- 2.1. vetitë fizike;
- 2.2. vetitë e rrezikshme për shëndetin;
- 2.3. vetitë e rrezikshme për mjedisin.
- 2.4. vetitë e rrezikshme për shtresen e ozonit.

### **Neni 7 Vetitë e rrezikshme fizike**

1. Substancat dhe përzierjet që kanë një nga vetitë e mëposhtme, konsiderohen si substanca me veti të rrezikshme fizike:

- 1.1. eksplozive;
- 1.2. gasra të ndezshme;
- 1.3. aerosole të ndezshme;
- 1.4. gazrat nën presion;
- 1.5. lëngje të ndezshme;
- 1.6. të ngurta të ndezshme;
- 1.7. substanca dhe përzierje vetë-reaguese;
- 1.8. lëngje piroforike;

- 1.9. të ngurta piroforike;
- 1.10. substanca dhe përzierje vetë-ngrohëse;
- 1.11. substanca dhe përzierje që kontakt me ujin, imitojnë/lirojnë gazra të ndezshme;
- 1.12. lëngje oksiduese;
- 1.13. të ngurta oksiduese;
- 1.14. peroksidet organike;
- 1.15. metalet koroze.

### **Neni 8** **Vetitë e rrezikshme për shëndetin**

1. Substancat dhe përzierjet konsiderohen të rrezikshme për shëndetin nëse ato kanë një nga vetitë e mëposhtme:

- 1.1. toksicitet akut;
- 1.2. korozeve /irituese për lëkuren;
- 1.3. dëmtim serioz të syve /iritim të syve;
- 1.4. ndjeshmëri për traktin e frymëmarrjes ose për lëkuren;
- 1.5. mutagjene për qelizat embrionale;
- 1.6. kancerogjene;
- 1.7. toksike për riprodhim-reproduktiv;
- 1.8. toksike për organin specifik që atakohet (STOT- Specific Target Organ Toxicity) Ekspozim i njehershëm;
- 1.9. toksike për organin specifik që atakohet (STOT) Ekspozim i përsëritur;
- 1.10. rrezik për frymëmarrje.



## **Neni 9**

### **Vetitë e rrezikshme për mjedisin**

1. Substancat dhe përzierjet që kanë veti të rrezikshme për mjedisin, përbëjnë:

1.1. rrezik për mjedisin ujor;

1.2. rrezik për mjedisin jujor.

2. Substancat dhe përzierjet kanë veti të rrezikshme për mjedisin, nëse paraqesin rrezik të menjëhershëm ose të vonuar, për një ose më shumë përbërës të mjedisit. Këto kimikate mund të jenë të qëndrueshme, bioakumuluese dhe toksike.

3. Substancat konsiderohen të qëndrueshme, bioakumuluese dhe helmuese (PBT- Persistent Bio-accumulative and Toxic) në qoftë se ato plotësojnë kriteret e përcaktuara në Kapitullin 1, të Shtojcës XIII të Rregullores (EC) Nr. 1907/2006.

4. Substancat konsiderohen si shumë të qëndrueshme dhe shumë bioakumuluese (vPvB- very Persistent and very Bioaccumulative) nëse ato plotësojnë kriteret e përcaktuara në Kapitullin 2 të Shtojcës XIII të Rregullores (EC) Nr. 1907/2006.

## **Neni 10**

### **Vetitë e rrezikshme për shtresën e ozonit**

Substancat dhe përzierjet me veti të rrezikshme për shtresën e ozonit janë ato që dëmtojnë shtresën e ozonit.

## **KREU III**

### **AUTORITETI KOMPETENT**

## **Neni 11**

### **Autoriteti Kompetent**

1. Autoriteti kompetent për administrimin e kimikateve në kuadër të këtij ligji është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

2. Ministria përcakton kushtet për administrimin dhe mbikqyrjen për; detergjentet, kimikatet e rrezikshme që përdoren në industrinë minerare/ekstraktive dhe të ngjyrave, substancat dhe përzierjet e rrezikshme që përdoren për hulumtime dhe studime shkencore në laboratorë dhe për koordinimin dhe mbikqyrjen e hulumtimeve shkencore të cilat do të kryhen sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ministria, sipas këtij ligji, është autoriteti kompetent për bashkëpunimin me Komisionin Evropian dhe Agjencinë Evropiane për Kimikate.

## **Neni 12**

1. Sipas këtij ligji Ministria:

1.1. harton legjislacionin dhe aktet nenligjore për menaxhimin e kimikateve në Republikën e Kosovës;

1.2. publikon listën e klasifikimit dhe etiketimit të harmonizuar të substancave të rrezikshme;

1.3. publikon listën e substancave me rrezik të lartë (të cilat shkaktojnë shqetësim-brengosje) - listën e substancave kancerogjene, mutagjene, azo-ngjyrave;

1.4. publikon listën e kimikateve të rrezikshme të ndaluara dhe kufizuara për përdorim;

1.5. mban regjistrin e përgjithshëm të kimikateve në Republikën e Kosovës;

1.6. lëshon leje për prodhimin, importin, eksportin, vendosjen në treg dhe përdorimin e kimikateve të rrezikshme;

1.7. lëshon leje për shfrytëzimin e substancave tension-aktive në detergjente;

1.8. bën heqjen e kimikateve nga tregu ose kufizimin e përdorimit të tyre kur përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisit;

1.9. bashkëpunon me Agjencionin Evropian për Kimikate (ECHA-European Chemicals Agency), agjencitë e vendeve tjera dhe Sekretariatit e Konventës Ndërkombëtare, të cilat merren me aspekte tjera të menagjimit të kimikateve;

1.10. realizon procedurën e njoftimit për pëlqim paraprak dhe procedurën për marrjen e pëlqimit në bazë të njoftimit paraprak për importin dhe eksportin e disa kimikateve të rrezikshme;

1.11. kryen veprimtaritë tjera të përcaktuara në këtë ligj, dhe harmonizimin me ligje të tjera në fuqi;

1.12. informon publikun e gjërë për ndikimin e kimikateve në shëndetin e njerëzve dhe mjedis dhe realizon masat për zvogëlimin e rrezikut nga rreziku gjatë shfrytëzimit të kimikateve;

1.13. mban të dhëna mbi rrezikshmërinë e kimikateve;

1.14. me akt nënligjor themelon zyrën informative për ndihmë “helpdesk”;

1.15. përmes Agjensisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, bënë Raport vjetor për gjendjen e kimikateve sipas nenit 14 të këtij ligji, mban evidencën për prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit e kimikateve dhe detergjenteve, mbledh të dhënat për kimikatet dhe detergjentet, i përpunon, vleron, si dhe bënë distribuimin e tyre.

## **KREU IV**

### **MENAXHIMI I INTEGRUAR I KIMIKATEVE**

#### **Neni 13**

##### **Masat dhe kufizimet për kimikatet**

1. Për kimikatet që nuk i plotësojnë të gjitha kërkesat sipas dispozitave të këtij ligji, duke rrezikuar shëndetin e njeriut dhe mjedisin, Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetsisë, urdhëron:

1.1. që kimikati të ndalohet përkohësisht për prodhim, import, vendosje në treg dhe përdorim;

1.2 tërheqjen e kimikatit nga qarkullimi në treg;

1.3 të ndërmerren masa tjera të nevojshme për kufizimin e përdorimit të kimikatit.

2. Për vendosjen e masave për kufizime, sipas nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1, të këtij neni, Ministria merr për bazë ndikimin e efekteve negative të kimikatit në shëndetin e njeriut dhe mjedisin, dhe sipas nevojës të zëvendësojë kimikatin për të cilin dyshohet.

3. Ndalohet shitja e kimikateve personave nën tetëmbëdhjet (18) vjeç dhe vendosja në treg dhe përdorimi i kimikateve nga personat nën tetëmbëdhjet (18) vjeç.

4. Ministria, me akt të veçantë, përshkruan kufizimet lidhur me ndalimin e prodhimit të kimikatit të caktuar, vendosjen në treg dhe përdorimin e tij.

#### **Neni 14**

##### **Hartimi i raportit vjetor për kimikate**

1. Ministria harton Raport vjetor për gjendjen e kimikateve.

2. Raporti për kimikatet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të jetë pjesë e Raportit për gjendjen e mjedisit të cilin e aprovon Qeveria e Republikës së Kosovës.

3. Raporti, sipas paragrafit 2 të këtij neni, përmban kryesisht: shënimet për llojet e kimikateve, shënimet për lejet e lëshuara për kimikatet që prodhohen, importohen, eksportohen, shënimet për hulumtimet e kryera për kimikatet, shënimet për laboratorët e akredituar dhe realizmin e strategjisë dhe planit të veprimit për menaxhimin e kimikateve.

### **Neni 15**

#### **Sistemi informues për kimikatet**

1. Shkëmbimi i informacioneve me institucionet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për kimikatet bëhet duke u bazuar në dispozitat e dokumenteve të ratifikuara nga organi kompetent i Republikës së Kosovës.
2. Mbledhja, përpunimi, ruajtja dhe shkëmbimi i informacioneve me institucionet vendore për kimikatet është detyrë e Ministrisë, duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji lidhur me detyrimet për informim mbi kimikatet.
3. Ministria informon publikun dhe autoritetet përkatëse për rreziqet që mund të rrjedhin nga përdorimi i substancave dhe përzierjeve të rrezikshme dhe të rekomandojë marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e rrezikut.
4. Ministria nxjerr dhe publikon udhëzime teknike për nevojat e informimit të publikut dhe publikon regjistrat e substancave dhe përzierjeve që janë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

### **Neni 16**

#### **Zyre informative – Helpdesk**

Ministria, me akt nënligjor themelon zyren informative për ndihmë “helpdesk” e cila informon dhe jep këshilla për prodhuesit, importuesit, furnizuesit, përdoruesit dhe çdo pale tjetër të interesuar në lidhje me përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre, sipas këtij ligji.

### **Neni 17**

#### **Strategjia për menaxhimin e kimikateve**

1. Ministria, harton Strategjinë për menaxhimin e kimikateve në Republikën e Kosovës.
2. Strategjia hartohet për një periudhë kohore dhjetë (10) vjeçare, të cilën e miraton Qeveria.
3. Strategjia përmban:
  - 3.1. vlerësimin e gjendjes dhe problemet në fushën e menaxhimit të kimikateve;

3.2. aktivitetet me përparësi që duhet të ndërmerren, masat për menaxhimin e kimikateve;

3.3. mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut;

3.4. detyrat kryesore për sigurinë nga kimikatet;

3.5. planin e veprimeve për zbatimin e strategjisë dhe

3.6. burimet e mundshme financiare.

4. Ministria harton Raportin vjetor për realizimin e Strategjisë dhe Planit për menaxhimin e kimikateve, sipas paragrafit 2, 3, 4, të nenit 14 të këtij ligji.

## **KREU V**

### **KLASIFIKIMI, PAKETIMI DHE ETIKETIMI I KIMIKATEVE**

#### **Neni 18**

##### **Rregullat e përgjithshme për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e kimikateve**

1. Ndalohet vendosja në treg dhe përdorimi i kimikateve të rrezikshme, nëse ato nuk janë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar sipas këtij Ligji dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj.

2. Prodhuesi, importuesi dhe furnizuesi, i cili lëshon në treg kimikatet obligohet që t'i klasifikojë, t'i paketojë dhe etiketojë në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore që dalin nga ky ligj.

3. Obligohet që kimikatet që i eksporton t'i paketoj dhe etiketojë në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore që dalin nga ai, përveç nëse është e nevojshme që kimikatet të paketoohen dhe etiketohen në mënyrë tjetër në pajtim me standardet ndërkombëtare, me kërkesë të vendit në të cilin eksportohen.

4. Klasifikimi, paketimi dhe etiketimi, përdoren për komunikimin e rrezikut që rrjedhë nga kimikatet dhe si pasojë, menaxhimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga kimikatet e rrezikshme.

#### **Neni 19**

##### **Klasifikimi**

1. Kimikate të rrezikshme, sipas nënparagrafit 1.19 të nenit 3 të këtij ligji, janë kimikatet që klasifikohen të paktën në një klasë të rrezikut.

2. Klasifikimi i kimikateve bëhet me qëllim të vlerësimit të vetive të tyre të rrezikshme të tilla si: vetive fizike, vetive që ndikojnë në shëndet dhe vetive që ndikojnë në mjedis, si dhe kritereve të tjera të caktuara për klasifikimin në klasa të caktuara të rrezikut.

## **Neni 20**

### **Detyrimet e përgjithshme për klasifikimin e kimikateve**

1. Çdo person fizik dhe juridik që vendos në treg kimikate të rrezikshme është i detyruar të bëjë klasifikimin e tyre sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi i një substance ose përzierje duhet të vlerësoj informatat e identifikuara, sipas kritereve për klasifikimin e kimikateve për çdo klasë të rrezikut, në mënyrë që të përcaktojë rreziqet që lidhen me substancën apo përzierjen.
3. Ministria, nëpërmjet akteve nënligjore, do të përcaktojë mënyren e klasifikimit, etiketimit dhe paketimit të substancave dhe përzierjeve të rrezikshme.
4. Ministria, me akte nënligjor, përcakton kërkesat/kriteret për klasifikimin dhe etiketimin e substancave dhe përzierjeve të rrezikshme sipas Rregullores (EC) Nr.1272/2008 nga Shtojca I; Pjesa 1, Pjesa 2, Pjesa 3 dhe Pjesa 4 e cila përmban: parimet kryesore për klasifikim dhe etiketim, vetitë fizike, rreziqet për shëndet, rreziqet për mjedisin.
5. Kimikatet e rrezikshme, kur është e nevojshme, duhet të klasifikohen sipas vlerave të lejuara kufitare të përqendrimit apo sipas parametrave të tjerë që mundësojnë vlerësimin e rreziqeve nga substancat dhe nga përzierjet që përmbajnë substanca të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin.
6. Ministria, me akte nënligjore, publikon listën e klasifikimit dhe etiketimit të harmonizuar të substancave të rrezikshme sipas Rregullores 1272/208/EC për CLP, Shtojca VI, si dhe rifreskimet e saja.
7. Ministria, kryen rifreskimet e të dhënave në Regjistrin e kimikateve të klasifikuara sipas këtij ligji si dhe Regjistrin e kimikateve të rrezikshme të vendosura në tregun e Republikës së Kosovës.

## **Neni 21**

### **Klasifikimi i substancave të rrezikshme**

1. Substancat klasifikohen sipas klasifikimit të substancave me përbërje kimike të njëjtë, nga “Lista e klasifikimit dhe etiketimit të harmonizuar të substancave rrezikshme”.
2. Nëse substanca nuk është në Listën e klasifikimit dhe etiketimit të harmonizuar të substancave të rrezikshme, ose kur një substancë e tillë që ndodhet në këtë listë nuk është klasifikuar për të gjitha klasat e rrezikshme, klasifikimi i kësaj substance bëhet mbi bazën e

analizës së të dhënave ekzistuese për vetitë e kësaj substance, duke u bazuar në rezultatet e analizave të reja për vetitë e saj, dhe krahasimin e këtyre të dhënave.

3. Klasifikimi, në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 1272/2008, nenet 8 dhe 10-15, përfshihet në Listën teknike të sigurisë për kimikatet, siç përcaktohet në paragrafin 4 të nenit 33 dhe paragrafin 1 të nenit 36 të këtij ligji.

## **Neni 22**

### **Klasifikimi i përzierjeve të rrezikshme**

1. Përzierjet e rrezikshme klasifikohen në bazë të vetive të tyre të rrezikshme dhe sipas kategorizimit të përcaktuar në nenin 6,7,8,9 dhe 10 të këtij ligji, duke marrë parasysh edhe papastërtitë që përmbajnë ato.

2. Përzierjet e klasifikuara si të rrezikshme specifikohen varsisht nga përmbajtja e një apo më shumë substancave përbërëse të cilat gjinden në Listen e klasifikimit dhe etiketimit të harmonizuar të substancave të rrezikshme duke u bazuar në legjislacionin e BE-së.

3. Klasifikimi i përzierjeve bëhet sipas vlerësimit të rrezikshmerisë së përzierjeve në bazë të të dhënave për vetitë e përbërësve që përmban përzierja, në bazë të analizës së të dhënave ekzistuese për rrezikshmërinë që paraqet përzierja, respektivisht me shqyrtimin e vetive përmes eksperimenteve direkte dhe krahasimeve të të dhënave të atyre, gjegjësisht rezultateve të vërtetuara me kriteret për klasifikimin e kimikateve.

## **Neni 23**

### **Paketimi i kimikateve dhe karakteristikat e paketimit**

1. Personat fizikë dhe juridikë duhet t'i paketojnë kimikatet në mënyrë të tillë që substancat dhe përzierjet brenda paketimit të mos paraqesin rrezik për njeriun dhe mjedisin gjatë përdorimit, ruajtjes, magazinimit apo transportit.

2. Paketimi i kimikateve të rrezikshme dhe produkteve që nuk janë të rrezikshme, por përmbajnë të paktën një substancë të klasifikuar si të rrezikshme, duhet të përmbajë emrin tregtar të kimikatit, emrin e substancës së rrezikshme që përmban përzierja, emrin dhe adresën e furnizuesit të kimikatit, sasinë e kimikatit që përmban ambalazhi, shenjat e rrezikshmërisë si dhe tekstin në të cilin përshkruhen vetitë e rrezikshme të kimikatit.

## **Neni 24**

### **Kërkesat për paketim**

1. Kimikatet e rrezikshme, sipas nënparagrafit 1.19 të nenit 3 të këtij ligji, vendosen në treg vetëm nëse janë të paketuara sipas kërkesave të mëposhtme :

- 1.1 paketimi duhet të parandalojë derdhjen ose rrjedhjen e përmbajtjes;
  - 1.2 paketimi duhet të përbëhet nga materiale të rezistueshme, në mënyrë që të shmangen rreziqet kur ato vijnë në kontakt me përmbajtjen;
  - 1.3 paketimet duhet të jenë të ngurta/të forta e të qëndrueshme;
  - 1.4 paketimi duhet të jetë i mbyllur mirë, të ketë mbyllje të shtrëngueshme;
  - 1.5 paketimi duhet të përmbajë etiketën me deklaratat me të dhënat, dhe shënimet e nevojshme.
2. Mbyllja e shtrëngueshme dhe shenjat e dallueshme me prekje, për disa kimikate, janë të detyrueshme për mbrojtjen e fëmijëve dhe të verbërve.
3. Njësia pakuese e destinuar për shitje me pakicë që përmban kimikate të rrezikshme, nuk duhet të ketë:
- 3.1. formë dhe pamje që mund të jetë tërheqëse për fëmijët ose që tërheq kureshtje e tyre, dhe/ose pamjen që e çorienton konsumatorin;
  - 3.2. format, pamjet dhe shenjat që përdoren zakonisht për ushqimet, ushqimet për kafshë, medikamentet dhe produktet kozmetike.
4. Dispozitat me hollësi për zbatimin e kushteve të paketimit sipas Regullores (EC) 1272/2008/EC për CPL, përcaktohen me akte nënligjore të cilat i nxjerr Ministri.
5. Kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të zbatohen edhe në rastet kur paketimi është bërë në përputhje me rregullat për transportin hekurudhor, rrugor, ajror, dhe përmes linjave të gypsjellësit dhe transportit postar.
6. Ministria, me akt nënligjor, përcakton rregullat për paketimin e kimikateve të rrezikshme.

## **Neni 25**

### **Etiketimi dhe paraqitja e rrezikut përmes etiketimit**

1. Substancat dhe përzierjet e klasifikuara si të rrezikshme etiketohen dhe të paketohen në përputhje me rregullat për klasifikimin e tyre, për të siguruar mbrojtjen e duhur nga rreziqet dhe për të siguruar informacionet e duhura.
2. Prodhuesi, importuesit dhe furnizuesit sigurojnë që paketimi i substancave ose përzierjeve që vendosen në treg apo shpërndahen për palën e tretë, të jenë të etiketuara në mënyrë të qartë dhe sipas nenit 27 të këtij ligji.



## **Neni 26**

### **Mënyrat për shënim dhe komunikim**

1. Etiketa dhe Lista Teknike e Sigurisë për Kimikatet (LTS) janë dy mjete të parapara për informim, që duhet të përdoren për të vënë në dukje rreziqet që vijnë nga përdorimi i substancave dhe përzierjeve të rrezikshme.
2. Etiketa është i vetmi mjet i drejtpërdrejtë për informim dhe komunikim me konsumatorët që shërben për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve dhe ti orientojë ata drejt informacionit gjithëpërfshirës për vetitë e substancave apo përzierjeve të caktuara.

## **Neni 27**

### **Përmbajtja e etiketës**

1. Një substancë ose përzierje e klasifikuar si e rrezikshme, në paketimin e saj përmbajë etiketën në të cilën duhen përfshirë elementet e mëposhtme:
  - 1.1. emri, adresa dhe numri i telefonit të personit fizik dhe juridik që vë në treg substancat e rrezikshme në Republikën e Kosovës;
  - 1.2. sasia e saktë e substancës ose përzierjes në paketim që dedikohet për përdorim me pakicë, përveç rasteve kur kjo sasi është specifikuar diku tjetër në paketë;
  - 1.3. identifikimi i kimikatit apo produktit;
  - 1.4. piktogramet/simbolet e rrezikut;
  - 1.5. fjalët paralajmëruese/sinjalizuese “Rrezik” ose “Kujdes”;
  - 1.6. deklaratat e rrezikut / frazat e rrezikut të tilla si “Zjarr”, “Rrezik gjithëpërfshirës”, “Vdekjeprurëse nëse gëlltitet” etj.;
  - 1.7. deklaratat përkatëse;
  - 1.8. një seksion për informacion shtesë.
2. Prodhuesit dhe importuesit që bëjnë furnizimin me substanca ose përzierje të rrezikshme për personat e tretë, sigurojnë që secili paketim të jetë i etiketuar në mënyrë të qartë dhe të përherëshme dhe të përmbajnë informatat në vijim:
  - 2.1. emrin e substancës ose përzierjes. Nëse substanca nuk është e regjistruar, atëherë emërtimi i saj bëhet sipas përshkrimeve të pranuar ndërkombëtarisht;

- 2.2. emrin, adresën e plotë dhe numrin e telefonit të personit përgjegjës për vendosje në qarkullim të kimikatit, që mund të jetë prodhuesi, importuesi apo distributori/shpërndarësi;
- 2.3. piktogramet dhe simbolet e rrezikshmërisë, ku tregohen edhe efektet e rreziqeve që mund të vijnë gjatë përdorimit të substancës, në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga Ministria;
3. Për substancat me veti të rrezikshme siç janë irrituese, të ndezshme dhe oksiduese, nuk është nevojshme vënia e deklaratave të rrezikut në paketim nëse pakëtimi nuk përmban më shumë se njëqind e njëzet e pesë mililitra (125 ml); kjo po ashtu aplikohet edhe në rastet kur e njëjta sasi substancave të dëmshme nuk është dedikuar për përdorim të gjerë.
4. Sipas këtij ligji, treguesit, si “nuk është helmues”, “nuk është e dëmshme”, apo tregues të tjerë të ngjashëm nuk lejohen të vendosen në paketimin e substancave kimike të rrezikshme.
5. Ministria, me akt nënligjor përcakton, dispozitat për zbatimin e kushteve për etiketim sipas Rregullores EC 1272 /2008 për CLP.
6. Në Republikën e Kosovës, çdo njësi pakëtuuese me kimikate të rrezikshme duhet ti bashkangjiten udhëzimet për përdorim në gjuhët zyrtare, në përputhje me kushtet e caktuara me këtë ligj.
7. Nëse substancat ose pëzierjet klasifikohen në përputhje me paragrafin 3 të nenit 27 të këtij ligji, ato duhet të etiketohen në përputhje me nenet 17 deri në 33 të Rregullores (EC) Nr. 1272/2008 dhe duhet pakëtuar në pajtim me nenin 35, të Rregullores (EC) Nr 1272/2008.
8. Ministria, me akt të veçantë nënligjorë, përcakton mënyren e etiketimit të kimikateve të rrezikshme.

## **Neni 28**

### **Reklamimi i kimikateve të rrezikshme**

1. Me këtë ligj, ndalohet reklamimi i substancave kimike që i përkasin një apo më shumë kategorive të specifikuar si të rrezikshme nga neni 6 të këtij ligji, nëse në to nuk ceken qartë kategoritë e rrezikut sipas nenit 7, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji.
2. Për kimikatet që mund të blihen pa etiketë, të dhënat për vetitë e tyre të rrezikshme duhet paraprakisht të bëhen të ditura me shkrim, në një fletë të veçantë, në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të lexueshme.
3. Reklamimi i kimikateve nuk duhet të fshehë rreziqet që ato mund të paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, gjithashtu nuk duhet të inkurajoj përdorimin, trajtimin ose asgjësimin e tyre në mënyrë të papërshtatshme.

4. Terma të tillë si "i degradueshëm", "ekologjikisht i padëmshëm", "miqësor për mjedisin" dhe "miqësor me-ujin" mund të përdoren në reklama vetëm nëse vetitë e përshkruara janë shpjeguar me hollësi.

5. Furnizuesit e kimikateve të rrezikshme ose të përzierjeve të klasifikuara si të parrezikshme, por që në përmbajtjen e tyre kanë të paktën një substancë të klasifikuar si të rrezikshme, gjatë reklamimit duhet të tregohen vetitë e rrezikshme të kimikateve. Reklamimi nuk lejohet të fshehë nga përdoruesit dhe publiku vetitë e rrezikshme të kimikateve.

6. Ministria, me akt nënligjor përcakton kushtet për reklamimin e kimikateve.

### **Neni 29**

#### **Testet dhe kërkesat për testime në njerëz dhe në shtazë**

1. Prodhuesit e substancave dhe përzierjeve të rrezikshme kryejnë testimet dhe vlerësimet e kimikateve sipas metodave bashkëkohore, në përputhje me njohuritë shkencore dhe teknike.

2. Testimet në shtazë për vlerësimin e kimikateve të reja sipas Direktivës 86/609/EEC e zvendësuar nga Direktiva 2010/63/EU, bëhen vetëm në rastet kur nuk ka alternativa të tjera të testimit për klasifikimin e kimikateve në baza shkencore.

3. Ndalohen testimet në njerëz sipas këtij ligji, por për nevoja, Ministria mund të përdorë të dhëna nga burime të tjera, nga studimet klinike, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin kombëtar të shëndetësisë publike të Kosovës dhe Institutin e Veterinës.

### **Neni 30**

#### **Metodat e testimit**

1. Testet për përcaktimin e vetive të substancave dhe përzierjeve kryhen sipas metodave të testimit të përcaktuara në Rregulloren (EC) Nr. 440/2008.

2. Metoda të tjera të testimit mund të përdoren nëse asnjë prej metodave nuk është specifikuar në paragrafin 1, të këtij neni;

3. Në qoftë se janë përdorur metoda të tjera për testim, prodhuesi tregonë dhe vërtetonë se këto metoda:

3.1. prodhojnë rezultate të vlefshme dhe

3.2. marrin parasysh mbrojtjen e shtazëve në rastin e testeve të tyre.

4. Testimet jo-klinike që kanë si qëllim përcaktimin e vetive të kimikateve të rrezikshme për shëndetin apo mjedisin, duhet të kryhen në përputhje me parimet e Praktikave të Mira Laboratorike (GLP), të përcaktuara në Direktivën 2004/10/EC

5. Nëse testimet nuk janë bërë sipas rregullave të GLP ose nuk përputhen plotësisht me to, personi i cili paraqet raportet e testimit duhet të bëjë të ditur arsyet e një përzgjedhje të tillë.

6. Studime ose testime të reja të kimikateve të rrezikshme në shtazë që kanë për qëllim mbledhjen e të dhënave për klasifikimin e substancave ose përzierjeve bëhen vetëm në rast se nuk ka mënyra të tjera për të siguruar informata të duhura, për vlerësimin e kimikateve. Për këto raste testimet në shtazë bëhen me Leje të veçantë nga Ministria në bashkpunim me Komisionin Evropian nën kushte të posaçme.

7. Për klasifikimin e substancave dhe përzierjeve përdoren edhe të dhënat e tjera që merren nga testimet e bëra në njerëz, siç janë; nga analizat për nevojat e gjykatave ose nga analiza klinike, që janë bërë për qëllime të tjera.

8. Ministria vendos për pranimin e rezultateve të testimit si të vlefshme, pas konsultimit me Agjensinë Evropiane të Kimikateve (ECHA) për vlerësim.

9. Për vlerësimin e vetive fizike, toksikologjike dhe ekotoksikologjike të kimikateve, Ministria me akte nënligjore përcakton metodat për testimin e substancave dhe përzierjeve të rrezikshme:

9.1. Ministria me akt nënligjor përcakton metodat për përcaktimin e vetive fizike;

9.2. Ministria me akt nënligjor përcakton metodat për përcaktimin e toksicitetit dhe efekteve tjera shendetësore;

9.3. Ministria me akt nënligjor përcakton Metodat përpërcaktimin e ekotoksicitetit.

### **Neni 31**

#### **Testimet joklinike të kimikateve**

1. Testimet jo klinike të kimikateve kanë si qëllim vlerësimin e kimikateve dhe vlerësimin e rrezikut të mundshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

2. Testimet jo klinike të kimikateve kryhen në laboratorë që punojnë sipas Praktikave të Mira Laboratorike (GLP).

3. Çertifikata GLP e lëshuar nga organi kompetent i shtetit anëtar të grupit punues për GLP, në kuadër të Organizatës Ekonomike për Bashkëpunim dhe Zhvillim (OECD), pranohet edhe në Republikën e Kosovës.

4. Ministria ose Ministria e Shendetesise, me akt nënligjor përcakton kushtet dhe kriteret për zbatimin e sitemit të Praktikave të Mira Laboratorike - GLP.

**Neni 32**  
**Heqja e kimikateve nga qarkullimi/tregu**

1. Një kimikat hiqet përkohësisht ose përfundimisht nga tregu në rast se vërtetohet se paraqet rrezik të papranueshëm për shëndetin e njeriut apo mjedisin, edhe në qoftë se kimikati plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe akteve që dalin nga ky ligj.
2. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, Ministria informon menjëherë organin kompetent - Agjensionin Evropian për Kimikate dhe shtetin ku prodhohet ky kimikat i rrezikshëm, duke dhënë arsyet për vendimin e marrë për heqjen e kimikatit nga qarkullimi.

**KREU VI**  
**INFORMACIONET PËR RRJETIN E SHITJES**

**Neni 33**  
**Kërkesat për Listen teknike të sigurisë për kimikatet**

1. Lista teknike e sigurisë për kimikatet sigurohet nga prodhuesi, importuesi apo furnizuesi dhe ju mundësonë përdoruesve për të marrë masat e nevojshme që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe sigurisë në vendin e punës dhe mbrojtjen e mjedisit.
2. Personi që plotëson Listën teknike të sigurisë për kimikate merrë parasysh që Lista teknike e sigurisë për kimikatet informonë përdoruesin e saj për rreziqet që mund të shkaktoj një substancë ose përzierje dhe të japin informacion mbi trajtimin, deponimin dhe asgjësimin e sigurt të substancës apo përzierjes.
3. Furnizuesi i cili i vendos në treg substancat dhe përzierjet e rrezikshme duhet të paraqesin falas për çdo shpërndarës apo përdorues të rradhës Listen teknike të sigurisë në letër apo në formë elektronike.
4. Lista teknike e sigurisë për kimikatet përmbanë të dhënat e cekura si më poshtë:
  - 4.1. identifikimi i kimikateve dhe personave fizik apo juridik;
  - 4.2. identifikimin e rrezikshmërisë;4.3. informatat mbi përbërësit;
  - 4.4. masat për dhënien e ndihmës së parë;4.5. masat për shuarjen e zjarrit;
  - 4.6. masat në rast të derdhjes aksidentale;
  - 4.7. përdorimi dhe magazinimi;

4.8. kontrolli ndaj ekspozimit / mbrojtja personale;

4.9. vetitë fiziko-kimike;

4.10. stabiliteti dhe reaktiviteti;

4.11. informatat toksikologjike;

4.12. informatat ekologjike;

4.13. përdorimi i mbeturinave;

4.14. informatat për transport;

4.15. informatat mbi rregullat;

4.16. informatat tjera.

5. Informatat e dhëna në Listën teknike të sigurisë për kimikatet duhet të përputhen me të dhënat në Raportin për sigurinë kimike dhe skenarin e ekspozimit.

6. Ministria, me akt nënligjor përcakton përmbajtjen e Listën teknike të sigurisë për kimikatet.

7. Të dhënat në Listën teknike të sigurisë për kimikatet paraqiten në gjuhën zyrtare.

8. Ministria, me akt nënligjor nxjerr Listën teknike të sigurisë për kimikatet duke i plotësuar kërkesat e REACH dhe ri-freskimet e saj sipas kërkesave dhe ndryshimeve nga Legjislacioni Evropian EU/453/2010.

### **Neni 34**

#### **Kërkesat specifike për Listën teknike të sigurisë për kimikatet**

1. Prodhuesi, importuesi, eksportuesi, furnizuesi apo shpërndarësi është detyruar ti pajis marrësit apo përdoruesit e kimikateve me kërkesat specifike në Listën teknike të sigurisë për kimikatet edhe nëse kimikati nuk i plotëson kriteret për klasifikim si i rrezikshëm, por përmban:

1.1. një përqendrim individual,  $\geq 1\%$  të peshës për përzierjet jo-të gazta, dhe  $\geq 0,2\%$  të vëllimit tek përzierjet e gazta, ku të paktën një substancë e përzierjes, paraqet rrezik për shëndetin e njeriut apo mjedisin;

1.2. një përqendrim individual,  $\geq 0,1$  për qind të peshës tek përzierjet jo-të gazta, të paktën një substancë që është PBT ose vPvB; substanca të tilla si ato që kanë veti të ndërpresin funksionimin e sistemit endokrin, si dhe substancat që janë klasifikuar si

kancerogjene, kategoria 1 ose 2 (ose kancerogjene, kategori 1A ose 1B), mutagjene, kategoria 1 ose 2 (ose mutagjene, kategori 1A ose 1B), apo toksike për sistemin riprodhues, kategoria 1 ose 2 (ose toksike për sistemin riprodhues, të kategorisë 1A ose 1B) ose substanca të tjera që paraqesin shqetësim;

1.3. substancat për të cilat janë përcaktuar përqendrimit maksimale të lejuara në zonat e punës.

### **Neni 35**

#### **Përjashtimet**

Lista teknike e sigurisë për kimikatet nuk është e nevojshme, kur informacioni për kimikatet për përdorim të gjere është i mjaftueshëm në lidhje me sigurinë, mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisin, përveç rasteve kur kërkohet nga përdoruesit ose furnizuesit.

### **Neni 36**

#### **Rifreskimet e Listës teknike të sigurisë për kimikatet**

1. Prodhuesi, importuesi, eksportuesi apo furnizuesi, rifreskon përmbajtjen e Listës teknike të sigurisë për kimikatet, sa herë që merren informacione të reja për kimikatet, veçanërisht për zvoglimin e rrezikut dhe kontrollit ose informatave të reja për rrezikshmerine e kimikatit duke përfshirë edhe rastet kur ndalohej ose kufizohet prodhimi, hedhja në treg ose përdorimi i tyre.

2. Prodhuesi, importuesi, eksportuesi apo furnizuesi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, i njoftojnë dhe ju dërgojnë Listën teknike të Sigurisë për kimikate, të rifreskuar, të gjithë përdoruesve të cilëve iu kane shitur/shpërndarë kimikate brenda dymbëdhjetë (12) muajve.

3. Ndryshimet në Listën teknike të sigurisë për kimikatet duhet të përmbajnë verejtjen “E rifreskuar”, shënimet e rifreskuara dhe datën kur janë bërë ndryshimet në Listën teknike të sigurisë për kimikatet.

### **Neni 37**

#### **Ruajta e Listës teknike të sigurisë për kimikatet**

Përdoruesit profesionalë ose tregtarët detyrohen të mbajnë Listën teknike të sigurisë për kimikatet, për aq kohë sa kimikatet e caktuara të vazhdojnë të përdoren në vendin e punës.

### **Neni 38**

#### **Raporti i sigurisë për kimikatet**

1. Personat që vendosin në treg kimikate të rrezikshme detyrohen të hartojnë Raportin e sigurisë për kimikatet, i cili përmban vlerësimin e sigurisë kimike në përputhje me kërkesat

sipas Aneksit I të Rregullores (EC) Nr 1907/2006, për çdo substancë më vete, në përzierje ose për një grup të substancave.

2. Raporti i sigurisë për kimikatet përfshin rezultatet nga:

- 2.1. vlerësimi i rrezikut për shëndetin;
- 2.2. vlerësimi i rrezikut fizik;
- 2.3. vlerësimi i rrezikut mjedisor;
- 2.4. vlerësimi i rrezikut për shtresën e ozonit;

### **Neni 39**

#### **Zbatimi dhe rekomandimi i masave për zvogëlimin e rrezikut**

Pavarsisht nga neni 4, të Direktivës 98/24/EC, personat që regjistrojnë substancat, në sasi prej dhjetë (10) ton ose më shumë në vit për regjistrues, bëjnë vlerësimin e rrezikut dhe hartojnë Raportin e sigurisë për kimikate.

### **Neni 40**

#### **Përfshirjet për vlerësimin e rrezikut**

1. Raporti i sigurisë për kimikate nuk përfshinë shqyrtimin e rreziqeve për shëndetin e njeriut nga:

- 1.1. ushqimet në kontakt me materialet sipas Rregullores (EC) Nr. 1935/2004 për materialet dhe artikujt e destinuar për të ardhur në kontakt me ushqimet;
- 1.2. produktet kozmetike sipas Direktivës 76/768/EEC.

### **Neni 41**

#### **Kontrolli i rrezikut dhe afati për ruajtjen e Raportit të sigurisë nga kimikatet**

1. Çdo person si regjistrues i substancave të rrezikshme identifikonë dhe zbaton masat e duhura për të kontrolluar në mënyrë adekuate rreziqet e identifikuara në vlerësimin e sigurisë për kimikatet, dhe t'i pajisë përdoruesit me Listën teknike të sigurisë për kimikatet, sipas nenit 33 dhe 34 të këtij ligji.

2. Çdo person si regjistrues i substancës së rrezikshme kërkohet të mbajë në dispozicion Raportin e sigurisë nga kimikatet dhjetë (10) vite pas përfundimit të përdorimit të kimikatit.



**Neni 42**  
**Regjistri i përgjithshëm i kimikateve**

1. Kimikatet që prodhohen, importohen ose vendosen në treg regjistrohen në Regjistrin e përgjithshëm të kimikateve.
2. Regjistrin e përgjithshëm të kimikateve e mban Ministria në formë të shkruar dhe elektronike.

**Neni 43**  
**Rregullat e përgjithshme për regjistrimin e substancave dhe përzierjeve**

1. Substancat dhe përzierjet e reja lejohet të prodhohen, vendosen në treg ose përdoren nëse ato janë të regjistruara në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Çdo prodhues ose importues i substancave dhe përzierjeve obligohet që të njoftoj Ministrinë dhe të dorëzojë kërkesën për regjistrim në Ministri.

**Neni 44**  
**Regjistrimi i kimikateve në Regjistrin e përgjithshëm për kimikate**

1. Regjistrimi i kimikateve në regjistrin e përgjithshëm për kimikate bëhet duke u bazuar në njoftimet nga prodhuesit, importuesit ose përdoruesit, të cilët janë të obliguar që informatat t'i dergojnë në Ministri, deri më 31 mars të vitit vijues për sasinë e prodhuar apo të importuar të kimikateve për vitin e kaluar.
2. Polimeret regjistrohen në regjistër të kimikateve.
3. Në regjistrin e përgjithshëm për kimikate regjistrohen edhe substancat dhe përzierjet që përmbajnë substanca të cilat shkaktojnë shqetësim.
4. Kërkesa për regjistrim në regjistrin e kimikateve përmban: emrin, adresën, numrin personal të prodhuesit importuesit, të dhënat për sasinë e kimikatit të prodhuar ose importuar, dedikimi i përdorimit dhe numri i regjistrimit të biznesit.
5. Bashkëgjitur me kërkesën për regjistrimin e kimikateve sipas paragrafit 1 të këtij neni jepen certifikatat e regjistrimit të biznesit, dosja për secilin kimikat, Lista teknike sigurisë për kimikatet, për ato kimikate që i posedojnë.
6. Dosja nga paragrafi 5 i këtij neni përmban:

- 6.1. emrin tregtar të kimikatit dhe emrin sipas nomenklaturës së kimikateve -IUPAC, si dhe emra tjerë identifikues të kimikateve;
- 6.2. të dhënat për sasinë e kimikateve të vendosura në qarkullim;
- 6.3. të dhënat për mënyrën e përdorimit të kimikateve;
- 6.4. të dhënat për përmbajtjen kimike;
- 6.5. klasifikimi dhe etiketimi i kimikateve;
- 6.6. shënimet për vetitë fiziko- kimike të kimikatit;
- 6.7. shënimet për efektet e kimikatit në mjedis;
- 6.8. rezultatet nga testimet toksikologjike dhe ekotoksikologjike;
- 6.9. mënyrat e mundshme të shndërrimit të substancave të rrezikshme në të parrezikshme;
- 6.10. shënimet për shkallën e pastërtisë dhe përmbajtjen e shtesave të rrezikshme në substancë, nëse ato janë të rrezikshme dhe nëse është e nevojshme për klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve të rrezikshme.

7. Përmbajtjen e dosjes me dokumenta për kimikatet dhe Regjistrin të kimikateve e përcakton Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

#### **Neni 45**

#### **Regjistri i substancave të rrezikshme që shkaktojnë shqetësime**

1. Substancat që janë karcinogjene, mutagjene, toksike për sistemin e riprodhimit vendosen në regjistrin e substancave që shkaktojnë shqetësime.
2. Regjistri i substancave që shkaktojnë shqetësime përmbanë këto të dhënat:
  - 2.1. identitetin e substancës;
  - 2.2. klasifikimin e substancës;
  - 2.3. mënyrën e përdorimit, për të cilën nuk paraqitet nevoja për përshkrim të masave shtesë për zvoglimin e rrezikut.
3. Regjistrin e substancave që shkaktojnë shqetësim e përcakton dhe mban Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

**Neni 46**  
**Vlerësimi profesional**

1. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë bënë vlerësimin profesional të të dhënave për regjistrin e kimikateve të paraqitura në dosje, për substancën ose përzierjen e cila posedon substancën që shkakton shqetësim, masat për reduktimin e rrezikut dhe mënyrën e monitorimit sistematik për përdorimin e substacave që shkaktojnë shqetësim.
2. Nëse Ministria vlerëson se masat për reduktimin e rrezikut nuk janë adekuate, detyrohet të përcaktoj masa tjera të përshtatshme dhe përcakton afatin për zbatimin e masave të caktuara.
3. Prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi janë të obliguar t'i zbatojnë masat nga paragrafi 2 i këtij neni.
4. Regjistrimi i substancave që shkaktojnë shqetësime, në regjistrin e kimikateve, bëhet me vendim, pas verifikimit të shenimeve të prezentuara në dosje, në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të kërkesë për regjistrimin e substancës në regjistrin e kimikateve.

**Neni 47**  
**Ndryshimi i të dhënave**

1. Prodhuesit ose importuesit janë të obliguar që të njoftojnë Ministrinë për çdo ndryshim në të dhënat e futura në regjistrin e kimikateve dhe i cili konsiston në:
  - 1.1. ndryshimin e statutit juridik të prodhuesit ose importuesit - emrin ose vendin, adresën;
  - 1.2. ndryshimin e përbërjes së substancës ose përzierjes;
  - 1.3. ndryshimet e prodhimit vjetor ose importit, ndryshimet e sasisë së substancës;
  - 1.4. ndryshimet dhe njohurit e reja lidhur me rrezikshmërinë për shëndetin e njeriut dhe mjedisin që mund të vie nga substancat. Këto ndryshime imponojnë ndryshimin e përmbajtjes së Listës teknike për siguri nga kimikatet;
  - 1.5. ndryshimet në klasifikimn dhe shënimin e kimikateve;
  - 1.6. ndryshimet në raportin e sigurisë për kimikatet.
2. Për ndryshimet e të dhënave nga paragrafi 1 të këtij neni, njoftimi duhet paraqitur në Ministri jo më shumë se tridhjetë (30) ditë nga dita ndryshimit.

**Neni 48**  
**Mbajtja e evidences dhe obligimi për t'i ruajtur të dhënat**

1. Prodhuesit ose importuesit janë të obliguar të mbajnë evidencë për kimikatet e rrezikshme për:
  - 1.1 identitetin e kimikateve;
  - 1.2 për shpërndarësit dhe përdoruesit si dhe sasi të e porositura të kimikateve ose të shpërndara ose të ruajtura;
  - 1.3. sasi të tëra të kimikateve që janë shitur përdoruesëve gjatë vitit kalendarik;
2. Të dhënat e evidentuara sipas paragrafit 1, të këtij neni duhet ruajtur së paku dhjetë (10) vite pas ndërprerjes së prodhimit, vendosjes në treg dhe përdorimit të kimikatit të caktuar.
3. Prodhuesit ose importuesit janë të obliguar që në afat ligjor të dorzojnë të dhënat e evidentuara në Ministri.
4. Mënyrën e mbajtjes së evidencës për kimikate përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.

**Neni 49**  
**Të dhënat për publikim nga regjistri i kimikateve të rrezikshme**

1. Të dhënat nga regjistri i kimikateve si dhe shënime tjera, që do të jenë në disponim për publikun janë:
  - 1.1. emri kimik sipas nomenklaturës IUPAC për substancat e rrezikshme;
  - 1.2. emri tregtar;
  - 1.3. klasifikimi dhe etiketimi /shënimi i kimikateve;
  - 1.4. shënimet për vetitë fiziko-kimike të kimikatit;
  - 1.5. shënimet për efektet e kimikatit në mjedis;
  - 1.6. rezultatet nga testimet toksikologjike dhe ekotoksikologjike;
  - 1.7. mënyrat e mundshme të shëndrrimit të substancave në të parrezikshme;
  - 1.8. shënimet për shkallën e pastërtisë dhe përmbajtjen e shtesave të rrezikshme në substancë, nëse ato janë të rrezikshme dhe nëse ato janë të nevojshme për klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve të rrezikshme.

2. Çdo person që konsideron se ka nevojë për ti mbajtur të dhënat konfidenciale, mund të kërkoj që informatat e ofruara në Ministri të mbahen konfidenciale, në mënyrë që të mos të dëmtohet. Në këtë rast është i obliguar të japë arsyetim të plotë në Ministri.
3. Çdo person mund të bëjë kërkesë në Ministri, për të marrë shënimet që ajo i posedon për kimikatet e rrezikshme;
4. Për personin që kërkon shënimet e caktuara për kimikatet e rrezikshme, Ministria do të ofroj shënimet, përveç nëse ato janë konfidenciale dhe ruhen sipas kërkesës së personit nga paragrafi 2 i këtij neni.
5. Para se Ministria të merr vendim për dhënien e shënimeve konfidenciale, Ministria është e obliguar të konsultohet me personin nga paragrafi 2 i këtij neni që ka kërkuar të mbahen të dhënat konfidenciale.
6. Personat zyrtarë edhe pasi të shkëputin kontratën e punës me Ministrinë, janë të obliguar të ruajnë të dhënat konfidenciale për personat nga paragrafi 2 i këtij neni.
7. Në vendimin nga paragrafi 5, i këtij neni mund të bëhet ankesa në Ministri;
8. Vendimi nga paragrafi 6, i këtij neni është përfundimtar dhe për kundërshtimin e tij duhet të inicohet konflikti administrativ në gjykatën themelore, në afat kohor prej tridhjetë (30) diteve nga dita e pranimit të vendimit përfundimtar .

## **Neni 50**

### **Emri kimik alternativ i kimikateve**

1. Në Listën teknike për siguri nga kimikatet ose në shënimet e ambalazht të substancës së rrezikshme, ose substancës apo substancave të rrezikshme në një përzierje, mund të përdoret emri kimik alternativ, ashtu që shfrytëzohet emri me të cilin identifikohen grupet më të rëndësishme funksionale kimike ose orjentime tjera të përshtatshme.
2. Prodhuuesi, importuesi ose përdoruesi i kimikateve të rrezikshme do të njoftoj Ministrinë për përdorimin e emrit kimik alternativ të substancës së rrezikshme që gjindet në përzierje.
3. Emri kimik alternativ për kimikate mund të përdoret në rastet kur emri i substancës mund të zbuloj konfidencialitetin e punës ose e cenon të drejtën në proninë intelektuale, nën kushtet që emri kimik alternativ do të ofroj informacione të mjaftueshme që ndërlidhen me sigurinë nga kimikati i rrezikshëm.
4. Ministria përshkruan vetitë e substancës për të cilën mund të përdoret emri kimik alternativ, si dhe përmbajtjen e njoftimit nga paragrafi 2 i këtij neni.

5. Ministria mund të marrë vendim për lejimin ose mos lejimin e përdorimit të emrit kimik alternativ nëse ekzistojnë informacione të bindshme se emri kimik alternative nuk ofron informacione të mjaftueshme për të marrë masa të nevojshme për siguri nga kimikati në ambiente të punës, për shëndetin e njeriut dhe mjedisin gjatë përdorimit të tij.

6. Në vendimin nga paragrafi 5, i këtij neni mund të bëhet ankesa në Ministri.

7. Vendimi nga paragrafi 6 i këtij neni është përfundimtarë dhe për kundërshtimin e tij duhet të inicohet konflikti administrativ në gjykatën themelore në afat kohor prej tridhjetë (30) diteve nga dita e pranimit të vendimit përfundimtar.

## **KREU VII**

### **VENDOSJA NË TREG, PRODHIMI, PËRDORIMI DHE MAGAZINIMI , NDALIMET DHE KUFIZIMET PËR KIMIKATEVE TË RREZIKSHME**

#### **Neni 51**

##### **Kufizimet dhe ndalimet**

1. Për kimikatet që paraqesin rrezik të papranueshëm për shëndetin dhe mjedisin, Ministria me akt nënligjor përcakton kufizimin, ndalimin për prodhimin, vendosje në treg dhe përdorim të tyre.

2. Nëse për shkaqe teknike, sociale dhe ekonomike, ndalimi dhe kufizimi sipas paragrafit 1, neni 13 të këtij ligji, për kimikatin e caktuar nuk mund të zbatohet, Ministria përcakton afatet kohore të obligueshme për zbatimin e ndalimit, kufizimit.

#### **Neni 52**

##### **Zbatimi i kufizimit dhe ndalimit**

Prodhuesi, importuesi dhe përdoruesit i substancave, përzierjeve dhe produkteve janë të obliguar t'i përmbahen kufizimit dhe ndalimit sipas dispozitave të nxjerra nga Ministria ose organi kompetent i BE-së.

#### **Neni 53**

##### **Leja për qarkullimin e kimikateve të rrezikshme**

1. Vendosja e kimikateve të rrezikshme në treg mund të bëhet vetëm nga personat të cilët janë të pajisur me Leje për qarkullimin (prodhimin, vendosjen në treg, përdorimin, ruajtjen/ dhe magazinimin) e ktyre kimikateve.

2. Leja për qarkullimin e kimikateve të rrezikshme i jepet personit i cili plotëson kushtet për menagjimin e sigurt të kimikateve të rrezikshme.
3. Leja për përdorimin e kimikateve të rrezikshme mund të lëshohet edhe për personat fizik ose juridik që zhvillojnë veprimtaritë për të cilat shfrytëzojnë kimikatet e rrezikshme siç janë veprimtaria e artit, veprimtaritë studimore shkencore dhe veprimtari të tjera specifike.
4. Leja për furnizimin, përdorimin e kimikateve të rrezikshme sipas paragrafit 1, të këtij neni do të jepet nëse arsyetimi për përdorimin e tyre është i bazuar, nëse kimikatet përdoren në mënyrë të sigurt, nëse ato përdoren për shkaqe të arritjes së efekteve në cilësi, ose në pamundësi për alternativa tjera.
5. Kushtet themelore për ruajtjen e kimikateve të rrezikshme janë: të posedoj një objekt të përgatitur për magazinimin e kimikateve, të siguroj që në atë objekt të mos ketë qasje për persona të pa autorizuar, të ketë kushte për mbrojtje fizike dhe mbrojtje nga zjarri si dhe sipas nevojës edhe kushte tjera parandaluese të rrezikut.
6. Ministria bënë regjistrin e kimikateve të rrezikshme dhe shumë të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin për të cilat lëshohet Leja, si dhe për kimikatet që nuk do të lëshohet Leje për qarkullim.

#### **Neni 54** **Kërkesa për Leje**

1. Kërkesa për Leje sipas paragrafit 1,2,3, dhe 4 të neni 53 të këtij ligji, duhet të përmbajë emrin e personit adresën e personit, shënimet për kimikatin e rrezikshëm, qëllimin e përdorimit të kimikatit, sasinë e kimikatit që synohet të qarkullohet.
2. Me kërkesën për Leje bashkangjiten dokumentet dhe shënimet:
  - 2.1. Leja mjedisore ose Pelqimin mjedisor për objektin dhe pajisjen ku prodhohen ose magazinohen kimikatet e rrezikshme;
  - 2.2. prezantohet Leja nga organi kompetent për situata emergjente, kur është e domosdoshme për posedim;
  - 2.3. përshkrimin e procesit të prodhimit për prodhuesit,
  - 2.4. Listën teknike për siguri nga kimikatet;
  - 2.5. çertifikaten e regjistrimit të biznesit;
  - 2.6. listen e kimikateve me numrin doganor ;
  - 2.7. kontraten mes shitësit dhe blerësit, për importuesit ose parafakturen;

2.8. dëshminë për stafin e kualifikuar;

2.9. CV e personit profesional për kimikate - përgjegjës për qështje profesionale.

3. Ministria do të përshkruaj:

3.1. formën e kërkesës për Leje;

3.2. vendimin për Leje për zhvillimin e qarkullimit me kimikate të rrezikshme;

3.3. udhëzimet për vendosjen e masave preventive për magazinim dhe ruajtje të sigurt të kimikateve të rrezikshme dhe për shfrytëzimin e tyre.

### **Neni 55**

#### **Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje**

1. Kërkesën e shqyrton komisioni i përbërë prej së paku pesë (5) anëtarve të kualifikuar nga drejtimit e shkencave natyrore, së paku dy (2) prej tyre nga lëmia e kimisë ose inxhinieri kimike.

2. Lejen për qarkullimin e kimikateve sipas paragrafit 1,2,3, dhe 4 të nenit 53 të këtij ligji, duhet shënuar emrin e personit që merr Lejen, qëllimin përse lëshohet Leja, afati i vleftëshmërisë së Lejes, emri i personit juridik përgjegjës.

3. Shqyrtimi i kërkesës për Leje dhe lëshimi i Lejes bëhen në afat kohor prej tridhjetë (30) ditëve pune.

### **Neni 56**

#### **Kohëzgjatja e Lejes**

1. Lejen për qarkullimin e kimikateve të rrezikshme e lëshon Ministria për importimin, prodhimin, magazinimin dhe përdorimin.

2. Për qarkullimin e kimikateve të rrezikshme Leja lëshohet për :

2.1. import ose eksport të kimikateve të rrezikshme në sasi të caktuar për një (1) vit kalendarik;

2.2. prodhimin e kimikateve të rrezikshme lëshohet për afat jo më shumë se dhjetë (10) vite;

2.3. magazinimin e kimikateve të caktuara lëshohet për pesë (5) vite;



2.4. përdorimin dhe trajtimin e kimikateve që lëshohet për dy (2) vite.

### **Neni 57**

#### **Taksa administrative për Lejet**

1. Për marrjen Lejes dhe për çdo ndryshim ose plotësim për Lejen e nxjerrur duhet aplikuar me dokumentacionin sipas nenit 54 të këtij ligji:

1.1. për marrjen e Lejes për import dhe eksport të kimikateve duhet paguar taksën administrative në vlerë prej dhjetë (10) euro;

1.2 për marrjen e Lejes për prodhimin e kimikateve duhet paguar taksën administrative në vlerë prej pesëdhjetë (50) euro;

1.3 për marrjen e Lejes për magazinimin e kimikateve duhet paguar taksën administrative në vlerë prej njëzet (20) euro;

1.4 për marrjen e Lejes për përdorimin e kimikateve duhet paguar taksën administrative në vlerë prej dhjetë (10) euro.

2. Taksa administrative sipas paragrafit 1 te këtij neni. paguhet në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Neni 58**

#### **Lëshimi dhe anulimi i Lejes**

1. Leja do të lëshohet nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuar me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi.

2. Ministria, përmes Lejes mund të vendosë kushte të veçanta për vendosjen në treg dhe përdorimin e kimikateve të rrezikshme.

3. Leja do të anulohet nëse nga personi janë prezantuar dokumente dhe shënime të pa sakta dhe është konstatuar se nuk plotësohen kushtet e shtruara në Lejen e nxjerrë më parë.

4. Poseduesi i Lejes është i detyruar t'iu përmbahet kushteve të përcaktuara në Leje për qarkullimin e kimikateve.

5. Ndaj vendimit nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni mund të bëhet ankesa në Ministri.

6. Kundër përgjigjes me vendim nga paragrafi 5 i këtij neni, mund të inicohet konflikti administrativ në gjykatën themelore, në afat kohor prej tridhjetë (30) diteve nga dita e pranimit të vendimit perfundimtar.

**Neni 59**  
**Mbajtja e shënimeve për Lejen**

1. Poseduesi i Lejes për qarkullimin e kimikateve të rrezikshme është i obliguar që të mbajë evidencëm për kimikate, për përdoruesit të cilëve i është shitur ose i është dhënë në përdorim kimikati i rrezikshëm, dhe të dhënat ti raportoj në Ministri.
2. Ministria, me akt të veçantë do të përshkruaj mënyrën e mbajtjes së evidencës me shënime për Lejet sipas paragrafit 1 të këtij neni lidhur me kimikatet e rrezikshme.

**Neni 60**  
**Ruajtja dhe magazinimi i kimikateve të rrezikshme**

1. Substancat dhe përzierjet e rrezikshme duhet të mbahen dhe të ruhen mirë në përputhje me llojin e rrezikut që mund të shkaktohet. Në veçanti, duhet:
  - 1.1. të mbrohen kundër ndikimeve të rrezikshme nga jashtë;
  - 1.2. të jenë të mbrojtura dhe të pa arritshme për palët e pa autorizuara;
  - 1.3. të mbahen ose ruhen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndonjë rrezik, të mos shkaktoj konfuzion për ngjashmëri me mallrat e konsumit të përgjithshëm, veçanërisht me ushqime, ose përdorimin gabimisht të tyre.
2. Kur substancat dhe përzierjet janë duke u ruajtur në magazina, duhet të merren parasysh këshillat dhe udhëzimet e dhëna në paketim dhe në Listën teknike të sigurisë për kimikatet.
3. Substancat dhe përzierjet e rrezikshme dhe paketimi i tyre duhet të mbrohen nga ndikimet e rrezikshme, veçanërisht nga ato të natyrës mekanike.
4. Substancat dhe përzierjet e rrezikshme duhet të jenë qartë të identifikueshme dhe gjatë ruajtjes në magazina duhet të mbahen të ndara nga mallrat e tjera.
5. Paragrafët 1 deri 3 të zbatohen edhe për objekte nga të cilat substanca ose përzierjet janë lëshuar në treg në sasi që mund të rrezikojnë shëndetin e njeriut ose mjedisin.
6. Substancat dhe përzierjet të cilat mund të reagojnë me njëra-tjetren duke shfaqur rrezik, duhet të ruhen ndaras.
7. Substancat dhe përzierjet e rrezikshme duhet të ruhen në enë që plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

7.1. paketimi i kimikatit nuk duhet të përngjaj apo të krijoj huti për shkak të ngjashmërisë së paketimit, siç janë produktet e ngjashme me paketimin e produkteve ushqimore, kozmetike, produktet terapeutike ose ushqimit për kafshët;

7.2. emri i substancës apo përzierjes duhet të jepen në etiketimin, dhe

7.3. paketimi duhet të jetë në përputhje me kërkesat nga neni 23 dhe 24, të këtij ligji.

8. Substancat dhe përzierjet kimike që plotësojnë kushtet të vlerësohen si mbeturina, do të trajtohen sipas ligjit për mbeturina.

## **KREU VIII**

### **EKSPORTI DHE IMPORTI I KIMIKATEVE TË CAKTUARA TË RREZIKSHME**

#### **Neni 61**

##### **Parimet e përgjithshme**

1. Me qëllim të avancimit të shpërndarjes së përgjegjësisë dhe bashkëpunimit në qarkullimin dhe tregtimin e kimikateve të rrezikshme, në harmoni me Konventën e Roterdamit, për procesin e dhënies së pëlqimit për eksport dhe import të substancave të caktuara për të cilat është përcaktuar ndalimi dhe kufizimi i prodhimit, si dhe për përzierjet e caktuara të cilat përmbajnë atë substancë të rrezikshme, do të zbatohet procedura për informim për pëlqim paraprak, respektivisht procedura e dhënjes së pëlqimit bazuar në informim për pëlqim paraprak (tutje - PIC – Procedura).

2. Kufizimet dhe ndalimi nga paragrafi 1, i këtij neni bazohen në kufizimet dhe ndalesat sipas Konventës së Roterdamit dhe nenit 51 dhe 52 të këtij ligji, këto kufizime dhe ndalesa vërtetohen duke u bazuar në dispozitat ligjore, sipas të cilave lejohet vendosja në treg e kimikateve të rrezikshme, me Ligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve , respektivisht Ligjin për produktet biocide.

3. Regjistri i kimikateve për PIC procedurë përmbanë emrin e kimikatit, numrat me të cilët identifikohet numri tarifor dhe kategorinë e kimikatit.

4. Regjistri i kimikateve për PIC-procedure përmbanë kimikatet nga Regjistri i Konventës së Roterdamit.

5. Ministria me akt të veçantë përshkruan procedurën për importin eksportin dhe transitin e kimikateve të rrezikshme.

## **Neni 62 Eksporti**

1. Eksporti i kimikateve nga regjistri i kimikateve që i nënshtrohen procedurës së njoftimit për pëlqim paraprak bëhet në bazë të njoftimit që e jep Ministria për shtetin në të cilin eksportohet.
2. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet për:
  - 2.1. kimikatet nga regjistri i kimikateve për procedurë të njoftimit paraprak;
  - 2.2. kimikatet që përmbajnë substancën nga regjistri i kimikateve që i nënshtrohen procedurës për njoftim për pëlqim paraprak me përqëndrim të tillë që paraqet rrezik, dhe
  - 2.3. prodhimet ose përzierjet që e posedojnë substancën që janë në regjistrin e PIC procedurës.
3. Njoftimin nga paragrafi 1 i këtij neni e përgatitë eksportuesi i kimikateve dhe e dërgon në Ministri.
4. Njoftimi nga paragrafi 3 i këtij neni përmban këto të dhëna:
  - 4.1. emrin dhe adresen për eksportuesin dhe importuesin;
  - 4.2. identitetin e substancës ose përzierjes;
  - 4.3. vetitë e kimikatit;
  - 4.4. masat për zvogëlimin e rrezikut.
5. Ministria bënë verifikimin e të dhënave gjatë njoftimit dhe pas verifikimit ato i dërgon shtetit në të cilin eksportohet kimikati.
6. Pas njoftimit Ministria lëshon dëshmi për eksportuesin e kimikatit.
7. Përmbajtjen e njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni, procedurat dhe afatet për zbatimin PIC procedurës e harton Ministria me akt nënligjor.

## **Neni 63 Importi**

1. Importi e kimikateve nga regjistri i kimikateve që i nënshtrohet procedurës së njoftimit për pëlqim paraprak bëhet në bazë të njoftimit që e merr Ministria nga organi kompetent i shtetit që eksporton kimikatin.

2. Ministria pasi që të pranoj njoftimin për eksportin e kimikatit nga organi kompetent sipas paragrafit 1 të këtij neni, atëhere e njofton këtë organ për pranimin e njoftimit.

#### **Neni 64**

#### **Qarkullimi i kimikateve sipas PIC procedurës**

1. PIC procedura zhvillohet për eksport ose import të kimikateve që gjenden në regjistrin e kimikateve për PIC procedur nga regjistri i Konventës së Roterdamit për Kimikate.

2. PIC procedura zhvillohet duke u bazuar në njoftimin që e bënë eksportuesi në Ministri.

3. Njoftimi nga paragrafi 2 i këtij neni përmban këto të dhëna:

3.1 emrin dhe adresen e eksportuesit dhe importuesit;

3.2. identitetin e substancës ose përzierjes;

3.3. vetitë fiziko - kimike, toksikologjike dhe ekotoksikologjike të kimikatit;

3.4. emri sipas IUPAC;

3.5. numrin CAS të kimikatit.

4. Ministria bënë verifikimin e të dhënave nga njoftimi dhe pas verifikimit i dergon njoftimin për pëlqim paraprak organit kompetent të shtetit eksportues për të dhënë pëlqimin.

5. Pasi që organi kompetent i shtetit ekportues, njofton Ministrinë se ka lejuar eksportin e kimikatit të rrezikshëm, Ministria lëshon pëlqim me shkrim për importuesin e kimikatit.

6. Ministria është e obliguar të jep pëlqim në lidhje me eksportin e kimikateve nga Kosova dhe të njoftoj Sekretariatit e Konventës së Roterdamit.

7. Ministria me akt të veçantë harton përmbajtjen e njoftimit nga paragrafi 3 i këtij neni, procedurat dhe afatin për zhvillimin e PIC procedurës.

8. Ministria harton Regjistrin e kimikateve që i nënshtrohen PIC procedurës.

9. Regjistri e kimikateve që i nënshtrohen PIC procedurës shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Neni 65**  
**Informata për sasi të e eksportuara dhe importuara të kimikateve**

1. Eksportuesit dhe importuesit e kimikateve nga nenet 63, 64, 65 të këtij ligji janë të obliguar që në Ministri të dërgojnë të dhënat për sasi të e eksportuara dhe importuara të kimikateve të caktuara, për shtetet nga janë importuar ose eksportuar dhe shënimet për eksportuesin dhe importuesin e kimikateve.
2. Të dhënat nga paragrafi 1, i këtij neni dërgohen në Ministri deri më 31 mars të vitit vijues, për vitin paraprak.
3. Në bazë të dhënave nga paragrafi 1, i këtij neni Ministria mbanë shenime për kimikatet e eksportuara dhe importuara.
4. Eksportuesit dhe importuesit e kimikateve janë të obliguar të njoftojnë Ministrinë me të dhënat për sasinë e importuar dhe eksportuar të kimikateve në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kryerjes së eksportit ose importit.
5. Shenimet nga paragrafi 3 i këtij neni mbahet në formën elektronike.
6. Ministria me akt të veçantë harton mënyrën e dërgimit të të dhënave nga paragrafi 1, i këtij neni.

**Neni 66**  
**Tranziti i kimikateve**

1. Eksportuesi i kimikateve është i obliguar të dërgoj informatat në Ministri me të dhënat që kërkohen nga organi kompetent i shtetit nëpër territorin e të cilit bëhet tranziti i kimikateve nga Regjistri i Konventës së Roterdamit, më së voni tridhjetë (30) ditë para se të bëhet tranziti.
2. Ministria jep informacionet për organin kompetent të shtetit nëpër territorin e të cilit bëhet tranziti i kimikateve në afat më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë para se të bëhet tranziti.

**Neni 67**  
**Regjistri i kimikateve të rrezikshme të ndaluara për eksport dhe import**

1. Substancat dhe përzierjet, përdorimi i të cilave është i ndaluar me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit nuk duhet eksportuar.
2. Kimikatet e rrezikshme të ndaluara për përdorim sipas Listës së Konventës së Roterdamit ndalohen të importohen.

3. Kimikatet që kanë afat përdorimi më pak se gjashtë (6) muaj, nuk lejohet të eksportohen apo importohen.

4. Regjistrin e kimikateve të rrezikshme, që janë të ndaluara për eksport, dhe import e harton Ministria.

5. Regjistri nga paragrafi 4, i këtij neni përmban: Emrin e kimikatit të rrezikshëm, numri me të cilin identifikohet kimikati dhe numrin tarifor të tij.

6. Dogana përmes inspektoratit fitosanitar verifikon zbatimin e procedurës për informim për pëlqim paraprak paraprak PIC-procedurës, për substancat dhe përzierjet nga regjistri sipas paragrafit 4 të këtij neni.

## **KREU IX INFORMIMI**

### **Neni 68**

#### **Qasja në të dhënat për kimikatet e rrezikshme**

1. Të dhënat që i posedon Ministria, në Regjistrat për kimikate si dhe shënime tjera, janë në disponim për publikun :

1.1. emri kimik:

1.1.1. sipas nomenklaturës IUPAC për substancat e rrezikshme;

1.1.2. sipas numrit CAS;

1.1.3. sipas numrit të KE.

1.2. emri alternativ kimik i substances;

1.3. emri tregtar;

1.4. klasifikimi dhe etiketimi i kimikatit;

1.5. shënimet për vetitë fizike dhe kimike të kimikatit;

1.6. shënimet për efektet e kimikatit në mjedis;

1.7. rezultatet nga testimet toksikologjike dhe ekotoksikologjike;

1.8. mënyrat e mundshme të shëndrrimit të substancave të rrezikshme në të

parrezikshme;

1.9. shënimet për shkallën e pastërtisë dhe përmbajtjen e shtesave të rrezikshme në substancë.

2. Çdo person që i paraqet të dhënat në Ministri dhe konsideron se ka nevojë për të mbajtur ato të dhënat konfidenciale, mund të kërkojë nga Ministria që të dhënat të mbahen konfidenciale. Në këtë rast ai është i obliguar të japë arsyetim të plotë.

3. Çdo person mund të bëjë kërkesë në Ministri për të marrë shënimet për kimikatet e rrezikshme nga Ministria.

4. Për personin që kërkon shënimet e caktuara për kimikatet e rrezikshme, Ministria ofron shënimet, përveç nëse ato ruhen sipas kërkesës së personit nga paragrafi 2 i këtij neni.

5. Para se Ministria të merr vendim për dhënien e shënimeve të ruajtuara, është e obliguar të konsultohet me personin që i ka vendosur të dhënat në ruajtje.

6. Kundër vendimit nga paragrafi 5, i këtij neni mund të bëhet ankesa në Ministri.

7. Kundër vendimit të Ministrisë, pala e pakënaqur ka të drejtë të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën themelore, në afat kohor prej tridhjetë (30) diteve nga dita e pranimit të vendimit përfundimtar.

## **KREU X DETERGJENTET**

### **Neni 69 Kërkesat e përgjithshme**

1. Detergjentet dhe detergjentet për përdorim në industri ose për përdorim profesional vendosen në treg nga prodhuesi, nëse substanca aktive që është prezent në detergjent i plotëson kriteret për zberthim të plotë biologjik dhe kushtet e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

2. Prodhuesi i detergjenteve nga paragrafi 1 i këtij neni është person fizik ose juridik që detergjentet i vendos në treg, të cilat i prodhon, importon ose i'u ndryshon karakteristikat e detergjentit.

3. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëjnë detergjentet - substancat tension-aktive në përbërjen e tyre nuk i plotësojnë kriteret për zberthim të plotë biologjik, vendosen në treg nëse Ministria jep Lejën për përdorim të substancës tension-aktive të caktuar, që ndërkohë është lejuar me dispozitat e legjislacionit të BE-së.



4. Të dhënat për përmbajtjen e detergjenteve që duhet të shenohet në paketim, si dhe rregullat e përgjithshme dhe të veçanta të shenimit, Ministria i përcakton me akt të veçantë.

5. Prodhuesi i detergjentit nga paragrafi 3 i këtij neni është i obliguar që të njoftoj Ministrinë për dispozitat e legjislacionit të BE-së që e lejojnë përdorimin e substancës tension-aktive përkatës.

6. Ministria me akt nënligjor përshkruan kushtet dhe kriteret për nxjerrjen e Lejes për prodhimin e detergjenteve.

### **Neni 70** **Leja për detergjentet**

1. Prodhuesi dhe importuesi i detergjenteve duhet të bëjë kërkesë për marrjen e Lejes para se të vendos në treg detergjentin që përmbanë substanca tension-aktive të caktuar.

2. Nëse Ministria vërteton se në detergjent përdoren substancat tension-aktive që nuk i plotësojnë kushtet ligjore atëhere nxjerr vendim për ndalimin e vleftëshmëris së Lejes paraprake dhe me këtë rast përcaktohet afati për tërheqjen nga tregu të detergjentit që përmban substancën tensioaktive jo-adekuate.

3. Ndaj vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni mund të parashtrohet ankesa në Ministri.

4. Kundër vendimit të Ministrisë, sipas paragrafit 3 të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën themelore, në afat kohor prej tridhjetë (30) diteve nga dita e pranimit të vendimit përfundimtar.

### **Neni 71** **Afati për lëshimin e lejes**

1. Përgjigja për Leje për prodhimin e detergjenteve lëshohet nga Ministria, në afat prej katër (4) muajve pas aplikimit me dosje complete të dokumentacionit të nevojshëm.

2. Leja do të lëshohet nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuar me këtë ligj dhe aktet tjera ligjore në fuqi.

3. Ministria përmes Lejes vendos kushte për vendosjen në treg të detergjentëve.

4. Poseduesi i Lejes është i detyruar t`ju përmbahet kushteve për të cilat është lëshuar Leja për vendosjen e detergjenteve në treg.

**Neni 72**  
**Regjistri substancave tension-aktive**

Regjistrin e substancave tension-aktive që përdoren në detergjente, për të cilat është dhënë Leje sipas akteve ligjore të BE-së, si dhe Regjistrin e substancave tension-aktive që janë ndaluar të përdoren për detergjente në BE duhet shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Neni 73**  
**Vlerësimi i detergjenteve**

1. Ministria me akte të veçanta do të përshkruaj kriteret dhe metodat për vlerësimin e detergjentëve dhe analizimin e zberthimit primar dhe zberthimit të plotë biologjik të substancës tension-aktive sipas kërkesave nga standardet dhe legjislacioni i BE-se për detergjentet.
2. Laboratori në të cilin bëhen përcaktimi dhe vërtetimi i karakteristikave të detergjenteve dhe substancave tension-aktive duhet të jetë i akredituar në Minsitrinë përkatëse.

**Neni 74**  
**Obligimet e veçanta për prodhuesin e detergjenteve**

1. Prodhuesi i detergjenteve është i detyruar të ruaj rezultatet e vërtetuara nga laboratorit.
2. Prodhuesi dhe importuesi i detergjenteve, përveq dispozitave për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve është i obliguar që detergjentet ti shënoi sipas dispozitave të këtij ligji.
3. Prodhuesi dhe importuesi i detergjenteve është i obliguar të mbaj Regjistrin e komponentave që përmban detergjenti i caktuar dhe shënimet nga regjistri tij t'i bëjë publike.
4. Prodhuesi i detergjentëve obligohet të ruaj shënimet nga regjistri sipas paragrafit 3 të këtij neni në afat kohor prej dhjetë (10) vitesh.
5. Ministria me akt të veçantë përshkruan mënyren për shënimin e detergjenteve, përmbajtjen e regjistrit për përbërjen e detergjentit, si dhe të dhënat që duhet bërë publike nga Regjistri sipas paragrafit 3 të këtij neni.

## **KREU XI**

### **MBIKQYRJA SISTEMATIKE E KIMIKATEVE**

#### **Neni 75**

#### **Mbikqyrja sistematike e kimikateve të rrezikshme**

1. Ministria është kompetente të zhvilloj dhe zbatoj mbikqyrjen e vazhdueshme të menaxhimit të kimikateve, vendosjes në treg dhe përdorimit të kimikateve, mbikqyrjen dhe kontrollin e gjendjes së kimikateve dhe ndikimit të tyre në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.
2. Për zhvillimin nga paragrafi 1 i këtij neni Ministria mund të angazhoj organizatat profesionale për hulumtime shkencore.

#### **Neni 76**

#### **Qendrat e kontrollit të helmimeve nga kimikatet e rrezikshme**

1. Qendrat për kontrollin e helmimit nga kimikatet e rrezikshme janë Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).
2. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Republikën e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, të dhënat e mbledhura për helmimet nga kimikatet detyrohen t'i dërgojnë në Ministri.
3. Ministria përdor të dhënat për mbajtjen e kontrollit lidhur me ndikimet e dëmshme të kimikateve në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

#### **Neni 77**

#### **Informatat për helmimet me kimikate të rrezikshme**

1. Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë publike dhe AUV si qendra të kontrollit janë të obliguara të mbledhin dhe japin informacionet për helmimet që ndodhin në Republikën e Kosovës.
2. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe AUV duhet të japin informacionet për masat parandaluese dhe trajtimin e helmimeve nga kimikatet e rrezikshme, si dhe rekomandojnë masa e duhura për parandalimin e rreziqeve nga helmimi.
3. Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike dhe AUV kanë të drejtë qasjeje në të dhënat e regjistrimit për kimikate në Ministri dhe të drejtën të kërkojnë të dhëna të nevojshme, drejtpërdrejtë nga prodhuesi dhe importuesi i kimikateve të rrezikshme, me qëllim të sigurimit të ndonjë informacioni shtesë për substancat dhe përzierjet e rrezikshme.

4. Ministria siguron të dhënat në dispozicion për qendrat e kontrollit sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni dhe, sipas nevojës edhe për të dhënat konfidenciale sipas paragrafit 2 dhe 5 të nenit 49 të këtij ligji;

5. Ministria në bashkëpunim me Institutin Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe AUV, për të parandaluar rrezikun për shëndetin e njeriut dhe mjedisit, me akt të veçant, përcakton kushtet dhe masat për menaxhimin e informacioneve për helmime.

### **Neni 78**

#### **Personi profesional përgjegjës për kimikate**

1. Prodhuesi dhe importuesi i kimikateve të rrezikshme obligohet që përmes kontratës të sigurojë një person profesional përgjegjës për zbatimin e rregullave ligjore dhe standardeve teknike për menaxhimin e kimikateve, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ky ligj.

2. Përdoruesi i kimikateve të rrezikshme obligohet që përmes kontratës të siguroj një person profesional përgjegjës për zbatimin e rregullave ligjore dhe standardeve teknike për menaxhimin e kimikateve, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ky ligj;

3. Personi profesional për kimikate duhet të jetë i kualifikuar në nivel univerzitar në degë të fushës së shkencave të kimisë, teknologjisë - inxhinieri kimike, farmakologji, farmacisë.

4. Ministria me akt të veçantë nënligjor përcakton kushtet, sektoret dhe fushat që përjashtohen nga obligimi sipas paragrafit 1 dhe 2, të këtij neni.

## **KREU XII**

### **MBIKQYRJA INSPEKTIMI DHE ZBATIMI**

#### **Neni 79**

#### **Mbikqyrja dhe inspektimi**

1. Mbikqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerrura nga ky ligj e bën Ministria.

2. Mbikqyrjen inspektive për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e bënë Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit dhe inspektorati fitosanitarë.

3. Mbikqyrja inspektive të kimikateve në Dogana e Kosovës e bënë Inspektorati fitosanitarë.

## **Neni 80**

### **Obligimet e Inspektoriatit**

Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit është i obliguar të përcjellë gjendjen e menaxhimit të kimikateve dhe të veproj në bazë të planit vjetor të inspektimit dhe të paraqesë raport vjetor për zbatimin e dispozitave të këtij Ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga ky ligj.

## **Neni 81**

### **Sigurimi i qasjes së lirë për inspektorin**

1. Personat fizik dhe juridik detyrohen që inspektorit:

1.1. t'i mundësohet inspektim dhe qasje e lirë për marrjen e shënimeve dhe informatave të duhura në lidhje me inspektimin;

1.2. t'i krijohet qasje me qëllim të kryerjes së detyrës së inspektimit, kontrollimit të hapësirës, objektit, aparaturave, pajisjeve dhe dokumentacionit;

1.3. t'i lejohet marrja e mostrave për të vërtetuar se kimikati i plotëson kushtet sipas dispozitave të këtij ligji për vendosje në treg.

2. Shpenzimet për ekzaminimet e vetive të substancave dhe perzierjeve kompenzohen nga prodhuesi, importuesi ose furnizuesi tjetër i kimikateve.

## **Neni 82**

### **Mbikqyrja e importit, eksportit dhe tranzitit të kimikateve**

1. Para se të aprovohet hyrja e kimikatit të rrezikshëm në qarkullim, Dogana e Kosovës (më tej Dogana) përmes inspektoratit fito sanitarë është e autorizuar për të kryer verifikimin e karakteristikave të kimikateve të rrezikshme që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë ligj.

2. Dogana përkohësisht ndalon zbatimin e procedurave të mëtejme doganore të kërkuara me qëllim të lejimit të kimikateve në qarkullim, nëse gjatë kryerjes së verifikimit të përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni vërtetohet se:

2.1. kimikatet e rrezikshme kanë karakteristika që çojnë në dyshimin se ato mund të paraqesin rrezik serioz për sigurinë, shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

2.2. kimikatet e rrezikshme nuk i shoqëron dokumentacioni që kërkohet me dispozitat e këtij ligji;

2.3. kimikatet e rrezikshme nuk janë shënuar, etiketuar, paketuar konform me dispozitat e këtij ligji;

3. Dispozitat e të këtij ligji zbatohen nga Dogana pa sjellë në pikëpyetje zbatimin e akteve të cilat rregullojnë sistemet specifike të kontrollit, që duhet zbatuar nga Dogana.

4. Në procesin e mbikëqyrjes së kimikateve të rrezikshme, inspektori i mbrojtjes së mjedisit është i autorizuar të:

4.1. ndaloj importimin e kimikateve të rrezikshme, qarkullimi i të cilave nuk është i lejuar në Republikën e Kosovës dhe urdhëron që e njëjta t'i kthehet dërguesit;

4.2. ndaloj kalimin tranzit të kimikateve të rrezikshme të cilat paketimi apo etiketimi i tyre nuk është në përputhje me dispozitat dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji si dhe të urdhëroj që kimikatet e rrezikshme të kthehen te dërguesi;

4.3. urdhëroj zbatimin e masave tjera për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit gjatë importit, eksportit dhe transitit të kimikateve.

### **Neni 83** **Detyrat e inspektorit**

1. Gjatë inspektimit, inspektori ka për detyrë të verifikoj se:

1.1. kimikati që vendoset në treg është i klasifikuar, etiketuar dhe paketuar sipas kushteve të përcaktuara sipas këtij ligji dhe dispozitave të nxjerrura nga ky ligj;

1.2. kimikatet janë të shpallura të rrezikshme dhe përzierjet që nuk janë të rrezikshme por përmbajnë së paku një substancë që është kualifikuar si e rrezikshme sipas dispozitave të këtij ligji;

1.3. mbahet evidencë dhe shënimet e përshkruara sipas këtij ligji, si dhe shënimet ruhen për afat të caktuar;

1.4. janë plotësuar obligimet sipas dispozitave ligjore në lidhje me përmbajtjen në Listen teknike të sigurisë për kimikatet;

1.5. janë dhënë shënimet të duhura dhe të mjaftueshme lidhur me vetitë e kimikateve, veçanërisht emri ose emri kimik alternativ i kimikateve;

1.6. mbeturinat nga kimikatet dhe paketimet e tyre trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të sigurt sipas dispozitave të ligjislacionit që rregullon menaxhimin e mbeturinave;

1.7. kimikatet janë magazinuar dhe ruajtur në mënyrë të sigurt dhe nuk rrezikojnë shëndetin dhe mjedisin;

- 1.8. kimikatet e rrezikshme të vendosura në treg për shitje si mall i konsumit të përgjithshëm, shiten sipas dispozitave ligjore;
- 1.9. është siguruar personi profesional me përgatitje dhe kualifikimet e kërkuara sipas këtij Ligji;
- 1.10. informimi dhe raportimet për kimikatet e rrezikshme janë bërë me kohë, të sakta dhe sipas dispozitave të këtij ligji;
- 1.11. për kimikatet e rrezikshme respektohen ndalesat dhe kufizimet sipas dispozitave të këtij ligji;
- 1.12. para se të bëhet eksportimi i kimikateve të rrezikshme sipas konventës së Roterdamit, zbatohen procedurat e informimit për pëlqim paraprak dhe informimi bëhet në kohën e duhur;
- 1.13. a është bërë kërkesa për zbatimin e PIC – procedurës;
- 1.14. kimikatet shumë të rrezikshme vendosën në treg dhe përdoren nga personat që posedojnë Lejen për qarkullimin e tyre;
- 1.15. personat që posedojnë Lejen për prodhim, importim dhe përdorim të kimikateve shumë të rrezikshme, posedojnë magazinat dhe vendet e përshtatshme për ruajtjen e sigurt të tyre, dhe i përmbahen masave preventive të sigurisë nga kimikatet;
- 1.16. me detergjentet veprohet në mënyrë si është përcaktuar në dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 84** **Autorizimet e inspektorit**

1. Gjatë kryerjes së detyrave nga neni 83 i këtij ligji, inspektori i mbrojtjes së mjedisit është i autorizuar të:

- 1.1 urdhëroj që kimikatet e vendosura në qarkullim të klasifikohen, etiketohen dhe paketohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerura nga ky ligj;
- 1.2 ndaloj vendosjen në qarkullim të kimikateve të klasifikuara, etiketuara dhe paketuara në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitave të nxjerura nga ky ligj;
- 1.3 urdhëroj që substancat e rrezikshme dhe përzierjet që nuk janë të rrezikshme por e përmbajnë një substancë të vlersuar si të rrezikshme të deklarohen dhe vlersohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerura nga ky ligj;

1.4 ndaloj deklarimin dhe vlerësimin e substancave të rrezikshme dhe përzierjeve që nuk janë të rrezikshme por në vete përmbajnë një substancë të vlerësuar si të rrezikshme sipas dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerura nga ky ligj;

1.5 urdhëroj që të mbahen shënimet e përcaktuara për kimikate dhe të njejtat të ruhen sipas afatit të caktuar në bazë të këtij ligji;

1.6 urdhëroj që të përmbushen detyrimet ligjore lidhur me dhënjen e Listës teknike të sigurisë për kimikatet;

1.7 ndaloj vendosjen në qarkullim të kimikateve të rrezikshme, të cilësuar si substance të ndaluara;

1.8 urdhëroj që përzierjet të cilat përmbajnë substanca me veti dhe përqëndrime të caktuara të ipen informacione të cilat janë të nevojshme për përdorimin e tyre të sigurt;

1.9 ndaloj përdorimin e emrit kimik alternative për substancat për të cilat nuk është njoftuar paraprakisht Ministria;

1.10 urdhëroj që kimikatet e rrezikshme t`i magazinohet në mënyrë të sigurt dhe mbeturinat, paketimet e zbrazta të kimikateve t`i ruaj dhe t`i trajtoj sipas legjislacionit për mbeturina;

1.11 ndaloj magazinimin e kimikateve të rrezikshme dhe mbeturinave të tyre, si dhe paketimet e zbrazta, në mënyrë joadekuate;

1.12 urdhëroj që kimikatet e vendosura në treg si mall i konsumit për përdorim të gjërë të shiten sipas dispozitave të këtij ligji;

1.13 ndaloj që kimikatet e vendosura në treg si mall i konsumit për përdorim të gjërë të shiten, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

1.14 urdhëroj prodhuesin, importuesin dhe përdoruesin të siguroj personin profesional për kimikate me kualifikim të kërkuar sipas këtij ligji;

1.15 ndaloj punën e prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit deri sa nuk e siguron personin profesional me kualifikim të kërkuar sipas këtij ligji;

1.16 urdhëroj që të raportoj sipas afatit të përcaktuar me këtë ligj për kimikatet që gjenden në regjistrin e kimikateve;

1.17 urdhëroj që për substancat të cilat shkaktojnë shqetësim të merren masat e nevojshme për ta vendosur në regjistrin e kimikateve;

1.18 të ndaloj substancat që shkaktojnë shqetësime derisa nuk zbatohen masat për ta vendosur në regjistrin e kimikateve;



1.19 të urdhëroj për zbatimin e ndalimeve dhe kufizimeve për kimikatet e rrezikshme sipas këtij ligji;

1.20 ndaloj prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave, me të cilat veprohet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji për ndalim dhe kufizime;

1.21 të urdhëroj tërheqjen e kimikateve nga tregu për të cilat nuk janë zbatuar ndalimet dhe kufizimet sipas këtij ligji;

1.22. urdhëroj që para eksportit të kimikateve të ipen informatat e caktuara më kohë, sipas dispozitave të këtij ligji lidhur me procedurën e informimit paraprak;

1.23. urdhëroj të bëhet kërkesa për zbatimin e PIC – procedurës;

1.24. ndaloj vendosjen në treg të kimikateve shumë të rrezikshme nga personat që nuk posedojnë Lejen;

1.25. urdhëroj që për kimikatet shumë të rrezikshme të sigurohet magazinimi i sigurt dhe të krijohen kushte si dhe të zbatohen masat preventive të caktuara me këtë ligj;

1.26. urdhëroj të veprohet në përputhshmëri me dispozitat që përcaktojnë obligimet për detergjentet;

1.27. ndaloj vendosjen në treg të detergjenteve, nëse nuk veprohet sipas dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerrura nga ky ligj për detergjente;

1.28. ndaloj prodhimin, qarkullimin, përdorimin e kimikateve të rrezikshme si dhe, sipas nevojës të urdhëron shkatërrimin e tyre, nëse konstaton se edhe përkundër përdorimit në mënyrën e duhur kimikatet mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;

1.29. urdhëroj masa tjera për të cilat është i autorizuar me këtë ligj dhe dispozitave tjera të nxjerrura nga ky ligj.

### **Neni 85** **Vendimi i inspektorit**

1. Masat që do të merren gjatë inspektimit, inspektori i përcakton me vendim.
2. Në rastin e ndërmarrjes së masave të shpejta për të evituar rrezikun e drejtpërdrejt për shëndetin e njeriut dhe mjedisit, inspektori me vendim sipas paragrafit 1 i këtij neni mund ta shqiptojë edhe me gojë dhe të urdhëroj ekzekutimin e tij menjëhere.
3. Inspektori merr vendime të menjëhershme dhe jep urdhër vetëm në rastet si në vijim:

3.1. kur rreziku për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njerëzve kërkon që të veprohet menjëherë dhe pa vonesë;

3.2. kur ekziston rreziku për fshehjen, ndryshimin apo shkatërrimin e provave në qoftë se nuk veprohet menjëherë.

4. Inspektori është i obliguar që vendimin e shqiptuar nga paragrafi 2 i këtij neni ta nxjerrë vendim me shkrim në afat më së largu prej tre (3) ditëve nga dita e shqiptimit të vendimit me gojë.

### **Neni 86**

#### **E drejta në ankesë**

1. Kundër vendimit të inspektorit mund të ushtrohet ankesë në Ministri në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së Vendimit të Inspektorit.

2. Ankesa daj vendimit të inspektorit nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

3. Ankesa ndaj vendimit të Ministrisë sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të ushtrohet në gjykatën kompetente.

### **Neni 87**

#### **Qasja e lirë për inspektorin**

Çdo person fizik dhe juridik që menaxhon me kimikate është i obliguar që inspektorit t'i mundësoj mbikqyrjen inspektive, dhe t'i vë në dispozicion për shiqim dokumentacionin e kërkuar dhe të nevojshëm për mbikqyrje.

### **Neni 88**

#### **Bashkëpunimi me inspektoratet tjera**

Nëse inspektori gjatë mbikqyrjes, konstaton se janë shkelur dispozitat e ligjeve tjera, të cilat kanë të bëjnë me ndikimet në shëndetin e njeriut, mjedisin, sigurinë dhe mbrojtjen në punë, është i obliguar që për këto raste të informoj organet tjera kompetente dhe në bashkëpunim të bëjnë mbikqyrjen inspektive dhe të mirren masat e nevojshme.

## **KREU XIII**

## **KUNDËRVAJTJET DHE MASAT NDËSHKUESE**

### **Neni 89**

#### **Kundërvajtjet dhe masat ndëshkuese**

1. Sipas këtij ligji, dënohet për kundërvajtje me gjobë në të holla në vlerë prej :

1.1. njëqind (100) deri në pesëqind (500) Euro, nëse bëhet vendosja në treg apo shitja e kimikateve të rrezikshme në treg nga personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe nëse kimikatet u shiten personave nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç sipas paragrafit 3 të nenit 13 të këtij ligji;

1.2. pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi, shitësi dhe përdoruesi i kimikateve nuk zbaton ndalimin, ose kufizimin e kimikateve sipas paragrafit 4 të nenit 13 të këtij ligji;

1.3. njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse personat që i vendosin substancat e rrezikshme dhe përzierjet në treg dhe ato nuk janë të klasifikuara, paketuara dhe etiketuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore që dalin nga ky ligj, sipas paragrafit 1 të nenit 18 dhe paragrafit 1 të nenit 20 të këtij ligji;

1.4. pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi i një substance ose përzierje nuk vlerëson informatat e identifikuar, në përputhje me kriteret për klasifikimin dhe përcaktimin e rrezikut që ndërlihet me substancën apo përzierjen përkatëse, sipas paragrafit 2 të nenit 20 të këtij ligji;

1.5. pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse paketimin e kimikateve nuk e bëjnë në mënyrë të përshtatshme, ashtu që substancat dhe përzierjet brenda paketimit të mos paraqesin ndonjë rrezik për njerëzit dhe mjedisin gjatë ruajtjes, magazinimit apo transportit sipas paragrafi 1 të nenit 23 të këtij ligji;

1.6. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse kimikatet e rrezikshme i vendosin në treg dhe të cilat nuk janë të paketuara në ambalazhe dhe paketime adekuatë të specifikuar në dispozitat e këtij Ligji sipas paragrafit 1 të nenit 24 të këtij ligji;

1.7. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse nuk e bëjnë mbylljen e shtrëngueshme dhe nuk vendosin shenjat e prekshme, për kimikatet e rrezikshme për të mbrojtur fëmijët dhe të verbërit sipas paragrafit 2 të nenit 24 të këtij ligji;

1.8. njëmijë (1.000) deri në pesëqind (2.500) Euro, nëse në njësinë paketuuese të destinuar për shitje me pakicë, e cila përmban kimikate të rrezikshme, i është dhënë forma, pamja që shkakton kureshtje dhe tërheqë fëmijët ose konsumatorin, ose gjason me pamjen dhe formën e ushqimeve për njerëz, kafshë ose medikamente mjekësore ose kozmetike, sipas paragrafit 3 të nenit 24 të këtij ligji;

1.9. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi, furnizuesi nuk ka siguruar që paketimi i substancave ose përzierjeve të cilat i shesin apo shpërndajnë për palen e tretë, të jenë të etiketuara në mënyrë të qartë dhe sipas nenit 27 dhe paragrafit 2 të nenit 25 të këtij ligji;

1.10. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse prodhuesi dhe importuesi, gjatë furnizimit me substanca ose përzierje të rrezikshme për personat e tretë, nuk siguronë që secili paketim të jetë i etiketuar në mënyrë të qartë dhe të përhershme dhe të përmbajnë informatat e specifikuar sipas paragrafit 2 të nenit 27 të këtij ligji;

1.11. pesëqind (500) deri në njëmijepesëqind (1.500) Euro, nëse treguesit, si ‘nuk është helmuese’, ‘nuk është e dëmshme’, apo treguesit të tjerë të ngjashëm janë vendosur në paketim të substancave apo përzierjeve të rrezikshme sipas paragrafit 4 të nenit 27 të këtij ligji ;

1.12. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse për çdo njësi të paketimit të kimikateve të rrezikshme, së bashku me të, nuk ofrohen udhëzimet për përdorim në gjuhët zyrtare sipas paragrafit 6 të nenit 27 të këtij ligji;

1.13. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse etiketimi i substancave nuk përputhet me kërkesat e specifikuar sipas paragrafit 8 të nenit 27 të këtij ligji;

1.14. dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse personi bën çfarëdo reklamimi të substancave kimike që i takojnë një apo më shumë kategorive të specifikuar si të rrezikshme nga neni 6 të këtij ligji dhe nuk ceken qartë kategoritë e rrezikut sipas neneve 7,8,9,10, si dhe paragrafit 1 të nenit 28 të këtij ligji,

1.15. pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse për kimikatet të cilat mund të blihen pa etiketë nga ana e publikut të gjërë, gjatë reklamimit të tyre, paraprakisht nuk jepen dhe tregohen në një fletë të veçantë apo me fjalë, të dhëna për vetitë e tyre të rrezikshme në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të lexueshme, sipas paragrafit 2 të nenit 28 të këtij ligji;

1.16. pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse gjatë reklamimit të kimikateve japet përshtypje e gabuar lidhur me rreziqet që ato paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin ose për pranueshmërinë e tyre mjedisore, dhe ato do të inkurajojë përdorimin, trajtimin ose asgjësimin e tyre në mënyrë të papërshtatshme, sipas paragrafit 3 të nenit 28 të këtij ligji;

1.17. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse personi do të përdorë terma të tillë si "i degradueshëm", "ekologjikisht i padëmshëm", "miqësor me mjedisin" dhe "miqësor me-ujë" në reklama por vetitë e përshkruara kështu, nuk janë në të njëjtën kohë të shpjeguara në detaje sipas paragrafit 4 të nenit 28 të këtij ligji;

1.18. pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse furnizuesit e substancave të rrezikshme dhe përzierjeve të caktuara, të cilat nuk janë të rrezikshme, por të cilat përmbajnë së paku një substancë të klasifikuar si të rrezikshme, nuk i kanë theksuar vetitë e rrezikshme të saj, kur ajo reklamohet, dhe reklamimi i saj bëhet në atë menyrë që të fshehin vetitë e rrezikshme të asaj substance nga përdoruesit dhe publiku, sipas paragrafit 5 të nenit 28 të këtij ligji;

1.19. pesëmijë (5.000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, nëse prodhuesit e substancave dhe nuk sigurojnë që zhvillimi i testimeve, metodave të testimit dhe vlerësimet e rezultateve të testit janë në përputhje me gjendjen aktuale të njohurive shkencore dhe teknike, sipas paragrafit 1 të nenit 29 të këtij ligji;

1.20. pesëmijë (5.000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, nëse personi zhvillon testimet e kimikateve të rrezikshme, që janë të ndaluara në qenie shtazore, sipas paragrafit 2 të nenit 29 të këtij ligji;

1.21. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse personi zhvillon testimet në njerëz që janë të ndaluara sipas paragrafit 3 të nenit 29 të këtij ligji;

1.22. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse testet për përcaktimin e vetive të substancave dhe përzierjeve nuk kryhen në përputhje me metodat e testimit të përcaktuara në Rregulloren (EC) Nr 440/2008 sipas paragrafit 1 të nenit 30, me përjashtim të paragrafit 2 të nenit 30 të këtij ligji;

1.23. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse testimet e caktuara nuk përputhen me parimet GLP, personi i cili paraqet raportet e testimit dhe nuk deklaron arsyet sipas paragrafi 5 të i nenit 30 të këtij ligji;

1.24. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse laboratorit bënë testimet e kimikateve të rrezikshme pa i plotësuar kushtet për zbatimin e GLP sipas paragrafit 2 të nenit 31 të këtij ligji;

1.25. pesëmijë (5.000) deri në njëzetëmijë (20.000) Euro, nëse nuk sigurohet Lista teknike e sigurisë për kimikatet nga prodhuesi, importuesit dhe furnizuesi, sipas paragrafit 1 të nenit 33 të këtij ligji;

1.26. dhjetëmijë (10.000) deri në tridhjetëmijë (30.000) Euro, nëse personi që plotëson Listën teknike të sigurisë për kimikate, nuk jep informacionet e duhura për të informuar përdoruesin e saj për rreziqet që mund t'i shkaktoj një substancë ose përzierje, dhe nuk japin informacion mbi trajtimin, deponimin dhe asgjësimin e sigurt të substancës apo përzierjes, sipas paragrafit 2 të nenit 33 të këtij ligji;

1.27. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse të dhënat e Listës teknike të sigurisë për kimikatet nuk korrespondojnë me të dhënat në Raportin për sigurinë kimike dhe me ato të skenarit të ekspozimit, sipas paragrafit 5 të nenit 33 të këtij ligji;

1.28. pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) Euro, nëse të dhënat në Listën teknike të sigurisë nga kimikatet nuk paraqiten në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas paragrafit 7 të nenit 33 të këtij ligji;

1.29. dhjetëmijë (10.000) deri në tridhjetëmijë (30.000) Euro, nëse prodhuesi, eksportuesi ose furnizuesi nuk i siguron për marrësit apo përdoruesit, Listën teknike për siguri nga kimikatet, edhe kur përzierja nuk i plotëson kriteret për klasifikim si e rrezikshme, sipas nenit 34 të këtij ligji;

1.30. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesi, eksportuesi ose furnizuesi, nuk bënë rifreskimin e përmbytjes së Listës teknike të sigurisë për kimikatet, kur ajo është e nevojshme duke përfshirë edhe rastet kur ndalohej ose kufizohet prodhimi, vendosja në treg ose përdorimi i tyre, nuk i njofton të gjithë përdoruesit, si dhe nuk shënon datën e ndryshimit të bërë sipas nenit 36 të këtij ligji;

1.31. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse përdoruesi profesional ose tregtari nuk ruan Listën teknike të sigurisë për kimikatet, për aq kohë sa substanca ose përzierjet e caktuara të vazhdojnë të trajtohen dhe përdoren në vendin e punës sipas nenit 37 të këtij ligji;

1.32. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse personat që vendosin në treg kimikate të rrezikshme nuk e hartojnë Raportin e sigurisë nga kimikatet, i cili përmban vlerësimin e sigurisë kimike në përputhje me kërkesat sipas Aneksit I të Rregullores (EC) Nr 1907/2006, për çdo substancë në vete, ose në përzierje, apo për një grup të substancave, sipas paragrafit 1 të nenit 38 të këtij ligji;

1.33. njëmijë (1.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi i substancave dhe përzierjeve nuk njofton Ministrinë dhe nuk dorëzonë kërkesë për regjistrim të substancave dhe përzierjeve në Ministri sipas neni 43 të këtij ligji;

1.34. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi ose përdoruesi i cili është i obliguar t'i dërgojë informatat në Ministri, nuk i dërgojnë ato deri më 31 mars të vitit vijues për sasinë e prodhuar, importuar të kimikateve për vitin e kaluar, sipas paragrafit 1 të nenit 44 të këtij ligji;

1.35. tremijë (3.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi nuk i përmbahen masave për reduktimin e rrezikut nga paragrafi 2 dhe 3 të nenit 46 të këtij ligji;

1.36. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesit ose importuesit nuk njoftojnë Ministrinë për çdo ndryshim për të dhënat e futura në regjistrin e kimikateve sipas nenit 47 të këtij ligji;

1.37. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesit ose importuesit nuk mbajnë evidencë për kimikatet e rrezikshme sipas nenit 48 të këtij ligji;

1.38. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi ose përdoruesi i kimikateve të rrezikshme nuk njofton Ministrinë për përdorimin e emrit alternativ të substancës së rrezikshme që gjindet në përzierje, sipas paragrafit 2 të nenit 50 të këtij ligji;

1.39. tremijë (3.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi i substancave, përzierjeve dhe produkteve nuk i përmbahet kufizimeve dhe ndalimit sipas dispozitave të nxjerra nga organi kompetent sipas nenit 51 dhe 52 të këtij ligji;

1.40. tremijë (3.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse vendosja e kimikateve të rrezikshme në treg bëhet nga personat të cilët nuk janë të pajisur me leje për qarkullimin e kimikateve, sipas paragrafit 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 53 të këtij ligji;

1.41. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse nuk i përmbushë kushtet themelore për ruajtjen e kimikateve të rrezikshme në një objekt të përgatitur për magazinimin e kimikateve, sipas paragrafit 5 të nenit 53 të këtij ligji;

1.42. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse poseduesi i lejes nuk i përmbahet kushteve për të cilat është lëshuar leja për qarkullimin e kimikateve sipas paragrafit 1,2, 3 dhe 4 të nenit 58 të këtij ligji;

1.43. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse poseduesi i lejes për qarkullimin e kimikateve të rrezikshme nuk mbanë evidencëm për kimikatet e rrezikshme dhe nuk raporton në MMPH, sipas paragrafit 1 të nenit 59 të këtij ligji;

1.44. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse substancat dhe përzierjet e rrezikshme nuk mbahen dhe ruhen mirë në përputhje me llojin e rrezikut që mund të shkaktohet nga ndikimet e jashtme, nga palët e pa autorizuara, apo të shkaktoj konfuzion për ngjashmëri me mallrat e konsumit të përgjithshëm, veçanërisht me ushqime sipas paragrafit 1 të nenit 60 të këtij ligji;

1.45. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse substancat dhe përzierjet e rrezikshme nuk janë qartësisht të identifikueshme që gjatë ruajtjes në magazina nuk mbahen të ndara nga mallrat e tjera sipas paragrafit 4 të nenit 60 të këtij ligji;

1.46. pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse substancat dhe përzierjet e rrezikshme të cilat janë të furnizuara ruhet në enë ose paketime që shkaktojnë huti për shkak të ngjashmërisë me paketimet e produkteve ushqimore, kozmetike, produktet terapeutike ose ushqimin e kafshëve sipas paragrafit 7 të nenit 60 të këtij ligji;

1.47. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse eksportuesit dhe importuesit e kimikateve ose përzierjeve nga nenet 63,64 dhe 65 të këtij ligji nuk dërgojnë në Ministri të dhënat me kohë për sasi të eksportuara dhe importuara të kimikateve dhe përzierjeve të caktuara, për shtetet nga të cilat janë importuar ose eksportuar dhe

shënimet për eksportuesin dhe importuesin e kimikateve sipas paragrafit 1, 2 dhe 4 të nenit 65 të këtij ligji;

1.48. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse eksportuesi i kimikateve dhe përzierjeve nuk i dërgon informatat në Ministri, për nevojat e organit kompetent të shtetit nëpër teritorin e të cilit zhvillohet tranziti i substancave dhe përzierjeve në kohën e caktuar sipas paragrafit 1 të nenit 66 të këtij ligji;

1.49. njëzetëmijë (20.000) deri në tridhjetëmijë (30.000) Euro, nëse personat që importojnë dhe eksportojnë substancat dhe përzierjet, përdorimi i të cilave është i ndaluar me qëllim për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 67 të këtij ligji;

1.50. shtatëmijë (7.000) deri në njëzetëmijë (20.000) Euro, nëse eksportohen kimikatat e rrezikshme që afati i përdorimit iu skadon 6 muaj pasi të eksportohen apo importohen sipas paragrafit 3 të nenit 67 të këtij ligji;

1.51. pesëmijë (5.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse prodhuesi dhe importuesi i detergjenteve nuk nxjerr Leje para se të vendosë në treg detergjentin që plotëson kushtet nga paragrafi 1 të nenit 69 dhe sipas paragrafit 1 të nenit 70 të këtij ligji;

1.52. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse nuk e tërheq nga tregu në afatin e caktuar detergjentin apo substancën tension-aktive për të cilin do të kërkohet ndalimi i përdorimit sipas paragrafit 2 të nenit 70 të këtij ligji;

1.53. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse bartësi i Lejes nuk iu përmbahet kushteve për të cilat është lëshuar Leja për vendosjen e detergjenteve në treg sipas paragrafit 4 të nenit 71 të këtij ligji;

1.54. dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse prodhuesi i detergjenteve nuk i ruan rezultatet nga shqyrtimet e kryera në laborator sipas paragrafit 1 të nenit 74 të këtij ligji;

1.55. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse prodhuesi i detergjenteve nuk mbanë Regjistrin e komponentave që përmban detergjenti i caktuar dhe nuk i ruan shënimet për kohë të caktuar si dhe nuk i bënë ato publike sipas paragrafit 3 të nenit 74 të këtij ligji;

1.56. dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi i kimikateve të rrezikshme nuk e emëron /siguron personin profesional për kimikate për mes kontratës, të siguroj një person fizik ose juridik përgjegjës për të dhënë këshilla lidhur me rregullat ligjore dhe standardet teknike për menaxhimin e kimikateve sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 78 të këtij ligji;



1.57. dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse personin profesional për kimikate nuk posedon kualifikimin e nivelit univerzitar të degëve dhe të fushave të caktuara sipas paragrafit 3 të nenit 78 të këtij ligji;

1.58. tremijë (3.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse personat fizik dhe juridik nuk i mundësojnë inspektorit mbikëqyrjen pa pengesa për marrjen e shënimeve dhe informatave të duhura apo kërkuara dhe mostrave sipas paragrafit 1 të nenit 81 dhe nenit 87 të këtij ligji.

2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, do të ndëshkohet me gjobë në vlerë prej njëqind (100) deri në njëmijë euro (1.000 €) edhe personi përgjegjës i personit juridik.

3. Personat që shkelin parimin e konfidencialitetit, nga paragrafi 6 neni 49 i këtij ligji edhe pasi t'iu ketë mbaruar punësimi, do të gjobitet për kundërvajtje në vlerë prej njëqindë (100) deri në njëmijë (1.000) Euro.

4. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, personit juridik, përkrah denimit në të holla me qëllim të marrjes së masave për siguri nga kimikatet, mund ti ndalohet edhe veprimtaria deri në pesë (5) vite.

5. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, me qëllim të marrjes së masave për siguri nga kimikatet, personit përgjegjës i personit juridik i ndalohet veprimtaria deri në dhjetë (10) vite.

## **KREU XIV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 90**

#### **Miratimi i strategjisë për menaxhimin e kimikateve**

Strategjia për menaxhimin e kimikateve hartohet nga Ministria dhe aprovohet nga Qeveria.

### **Neni 91**

#### **Miratimi i Planit për siguri nga kimikatet**

Qeveria e Kosovës me propozim të Ministrisë miraton Planin nacional të sigurisë nga kimikatet në afat prej katër (4) vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 92**  
**Miratimi i akteve nënligjore**

Qeveria dhe Ministria janë të detyruara që të gjitha aktet nënligjore të cilat dalin nga ky ligj, t'i nxjerrin në afat prej tri (3) vite nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 93**  
**Harmonizimi i aktiviteteve**

Të gjithë personat të cilët prodhojnë, qarkullojnë ose përdorin kimikate të rrezikshme, harmonizojnë aktivitetet e tyre me dispozitat e këtij ligji, në afat prej dymbëdhjetë (12) muaj, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 94**  
**Shfuqizimi**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-116 për Kimikate shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/8 dhe çdo dispozitë tjetër që rregullon fushën e kimikateve të rrezikshme dhe është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Perjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, benë udhëzimi administrativ nr. 10/2010 për listen teknike të sigurise për kimikatet dhe mënyren e plotesimit të saja, që mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e aktit të ri.

**Neni 95**  
**Zbatimi i procedurës administrative**

Për zbatimin e këtij ligji, zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative.

**Neni 96**  
**Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-197**  
**27 shkurt 2014**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

\_\_\_\_\_  
**Jakup KRASNIQI**